



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 116, Qershor 2013
Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

JO GJAKMARRJES, SËBASHKU PER JETËN



RITI I LINDJES SË FËMIJËS

Martesa është mbjellja e farës në ugarin e jetës, lindja e fëmijës është ripërtëritja jetës, dhe gëzimi më i madh i prindërve, familjes dhe gjithë rrethit shoqërorë.



Jeta e panjohur e babait të Nënë Terezës

Pothuajse të gjithë autorët e huaj që shkruajnë për Nënë Terezën, theksojnë në mënyrë të veçantë atdhedashurinë e prindërve të saj, sidomos të babait, Kolë Bojaxhiut. Prelati austriak Mons. Leo Masburg në kapitullin e 9-të të librit "Nënë Tereza e Kalkutës" (portret personal) botuar nga Ignatius Press në Shtetet e Bashkuara në vitin 2011, shkruan shumë edhe për babain e saj, Kolë Bojaxhiun. Ai shkruan se Kolë Bojaxhiu kishte lindur në Prizren.

Kolegji saverian

Shkollave katolike në Shkodër, më 17 tetor 1877 i shtohet edhe kolegji saveriane, me themelues At Luigj Mazza, i cili, edhe pse mësues i ri, i dhuroi prej pasurisë së tij kësaj shkolle 1100 napolona ar. Hapja e kësaj shkolle u arrit edhe në sajë të 22 qytetarëve shkodranë nga paria e besimit katolik, të cilët në një takim që patën me drejtorin e financës të vilajetit të Shkodrës, i parashtruan nevojën e hapjes së një shkolle të mesme, duke e pajisur atë me mjetet e nevojshme për një funksionim normal. Kontributit të jashtëzakonshëm financiar të At Luigj Mazës iu shtua edhe ai i besimtarëve katolikë, të cilët arritën të mbledhin edhe 500 napolona ari...

Gjurmëve të lashtësisë së fshatit Gjuraj

Reportazh
Duke e parë në gjithë ato angazhime në Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini", duke e parë qëndrimin e tij, korrektësinë dhe gjithë atë energji pozitive në këshilla e biseda me njerëz, nuk ke e si të mos e respektosh Ndue Sanajn. Ai disa herë ka ardhur në Kosovë në krye të përfaqësuesve të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në kuadër të veprimtarive të përbashkëta me Shoqatën e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" dhe prezenca e këndejme që të tejkaloheshin lodhja dhe ndonjë shqetësim.

Vëllimi poetik "Mjegull" i poetit Lazer Kodra



SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi
Botimin:
**NDUE
FTONI**



Jeta e panjohur e babait të Nënë Terezës

Nga Gjekë Gjonlekaj
New York

Pothuajse të gjithë autorët e huaj që shkruajnë për Nënë Terezën, theksojnë në mënyrë të veçantë atdhedashurinë e prindërve të saj, sidomos të babait, Kolë Bojaxhiut. Prelati austriak Mons. Leo Masburg në kapitullin e 9-të të librit "Nënë Tereza e Kalkutës" (portret personal) botuar nga Ignatius Press në Shtetet e Bashkuara në vitin 2011, shkruan shumë edhe për babain e saj, Kolë Bojaxhiun. Ai shkruan se Kolë Bojaxhiu kishte lindur në Prizren. Pas vitit 1900 ishte vendosur në Shkup, i cili në atë kohë quhej Uskup, tani kryeqytet i Maqedonisë. Atje punoi si farmacist dhe më vonë si arkitekt, deri kur u bë ortak në një ndërmarrje me një koleg. Dranja, nëna e Gonxhe Bojaxhiut ishte 16-vjeçare, kur u martua me burrin e saj Kolë Bojaxhiun. Ai ishte 34 vjeç, domethënë 18 vjet më i moshuar se nusja e tij. Në vitin 1905, Dranja lindi vajzën e parë të cilën e pagëzuan me emrin Age, dhe në vitin 1908 lindi djalin, Lazëri. Dhe më 26 gusht të vitit 1910 erdhi në këtë botë Agnes (Gonxhe) Bojaxhiu.

Në vitin 1910 Shkupi kishte 47 mijë banorë shumica shqiptarë të besimit mysliman. Shkupi kishte shumë banorë të besimit ortodoks. Katolikët ishin pakicë, por shumë të vendosur. Shkupi ishte nën sundimin e Perandorisë Otomane deri në Luftën e Parë Ballkanike, që filloi në vitin 1912 dhe pastaj u bë pjesë e Serbisë.

Nënë Tereza nuk është parë kurrë pa rruzarë në dorë. Rrënjët e devotshmërisë burojnë nga fëmijëria e saj. Nëna e tyre ishte shumë fetare. Gonxhja mësoi prej nënës dimensionin social të besimit. Ajo vizitonte vazhdimisht të sëmurët dhe të varfërit. Familja e Nënës Tereze ishte shumë e zhvilluar deri në kohën kur vdiq babai i saj në moshën 46-vjeçare. Kolë Bojaxhiu ishte tepër i interesuar për çështje politike dhe luftonte për të drejtat e shqiptarëve dhe pas një kohë u bë anëtar i këshillit të qytetit të Shkupit. Në vjeshtën e vitit 1918 një delegacion i këshillit të qytetit të Shkupit ku bënte pjesë edhe Kolë Bojaxhiu udhëtuan për në Beograd të ftuar

për një mbledhje. Posa u largua nga Beogradi, Kola u sëmur rëndë, duke përjetuar dhimbje të mëdha. Pasi arriti në Shkup u shtrua urgjentisht në spitalin e atij qyteti dhe vdiq disa orë më vonë.



Lazri, djali i tij tërë jetën ka qenë i bindur se babain e tij e kishin helmuar serbët për shkaqe politike. Lazër Bojaxhiu ka qenë kolonel në Ushtrinë



Shqiptare para Luftës së Dytë Botërore. Ai kishte mbaruar Akademinë Ushtarake në Itali. Ai u largua nga Shqipëria në fillim të Luftës së Dytë. Lazër Bojaxhiu kishte shumë miq shqiptarë në diasporë sidomos në Itali dhe në Shtetet e Bashkuara. Ai vizitoi disa herë New York-un, Bostonin dhe qytetet e tjera ku jetojnë shqiptarët. Ai pritej mirë dhe me nderime në New York, madje merrte pjesë në aktivitete të ndryshme nacionale. Madje, në një seminar në Universitetin Columbia, Lazër Bojaxhiu e kishte kundërshtuar Profesor Stavro Skendin për disa pikëpamje akademike rreth kulturës shqiptare. Ai ishte shumë i nderuar në shoqërinë

italo-amerikane. Si vëlla natyror i Nënës Terezës ishte shumë i privilegjuar edhe në shoqërinë amerikane. Ai merrte pjesë në konferenca ndërnacionale dhe në ceremoni të ndryshme ku merrte pjesë Nëna Tereze.

Ai fliste shumë për çështjen shqiptare. Lazër Bojaxhiu vdiq në vitin 1981 në Palermo të Sicilisë, në moshën 73 vjeçare. Disa dite pas vdekjes së tij, Kardinali Cooke i New Yorkut tha për të meshën e dritës në Katedralen Shën Patriku.

Nëna Tereza vdiq me 5 shtator të vitit 1997. Prej asaj dite e deri në ditën e varrimit me 13 shtator shtypi qendror dhe mjetet e tjera elektronike të informacionit të Indisë u morën me biografinë dhe veprimtarinë e Nënës Tereze, duke vënë vazhdimisht në dukje gjenocidin serb kundër shqiptarëve. Gazetat e Indisë shkruanin se babai Nënës Tereze, Kolë Bojaxhiu, ishte helmuar në Beograd nga serbët anti-shqiptarë. Gazetat shkruanin gjerësisht për gjenocidin serb në Ballkan, sidomos në Bosnjë dhe në Kroaci, pasi që lufta në Kosovë ende nuk kishte filluar. Shumë nga ato shkrime i lexova gjatë ditëve sa qëndrova në Kalkutë për varrimin e Nënës Tereze.

Shumë autorë të huaj kanë vënë në dukje atdhedashurinë e Kolë Bojaxhiut. Ata shkruajnë se Kolë Bojaxhiu organizoi një pritje madhështore në shtëpinë e tij me rastin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë me 28 Nëntor të vitit 1912. Mad-

je, në atë gëzim të madh nacional kishte marrë pjesë edhe Bajram Curri. Gjithë natën kënduan dhe kishin shtënë me armë. Bajram Curri i kërkoi falje Dranes për gjumin e trazuar të fëmijëve. Dranja ishte përgjigjur se Lazri e Ageja mund të jenë trazuar, por Gonxhes as topat nuk ia prishnin gjumin. Gazeta "The Washington Post" në shtator të vitit 1997 shkruante se, Gonxhja e vogël shumë herë kishte kënduar për Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë. Babai i saj, Kola e detyronte të këndonte në ceremonitë e 28 Nëntorit. Gazeta shkruante se Nënë Tereza ndoshta mund të ishte një soprano e mirë. Nënë Tereza thotë se shtëpia e tyre në Shkup ishte shndërruar në një Kuvend (Parlament) për çështje shqiptare. Dera e shtëpisë sonë ishte gjithmonë e hapur për patriotët shqiptarë, thotë ajo. Pas vdekjes së babait patriotët shqiptarë nuk vinin më në shtëpinë tonë, sepse u shndërrua në një shtëpi lutjesh fetare.

Më 1934 Dranja dhe motra Age u vendosën në Tiranë. Me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë është folur e shkruar shumë për patriotët shqiptarë. Por asnjëherë nuk është përmendur emri i Kolë Bojaxhiut. Në qoftë se merret parasysh veprimtaria e tij nacionale, Ai bashkpunoi me intelektualët dhe patriotët më të njohur të kohës. Në shtëpinë e tij gjetën mbështetje Hasan Prishtina, Lazër Mjeda, Mati Logoreci, Bajram Curri dhe të gjithë intelektualët dhe patriotët shqiptarë. Kolë Bojaxhiu ishte arkitekt dhe farmacist dhe për një kohë të gjatë i ushtroi si specialist këto profesione. Kole Bojaxhiu nderoi disa objekte kulturore në qytetin e tij. Ai ishte humanist dhe filantropist. Luftoi tërë jetën për Shqipëri etnike dhe bashkim nacional. Këtë qëllim e kishte deklaruar në takimet e tij me patriotët e Rilindjes shqiptare. Për qëndrimet e tij politike tregonin djali i tij Lazri dhe Nëna Tereze. Ajo u shmangej deklaratave politike, madje as për helmimin e tij nuk ka folur kurrë, sepse parimi i saj moral e shpirtëror nuk e lejonte një gjë të tillë. Për vdekjen e tij tragjike dhe mis-

terioze fliste vazhdimisht Lazri, edhe para autoriteteve të larta të vendeve të ndryshme. Jeta, veprimtaria dhe varret e Bojaxhive shtrihen në gjithë anët e Arbërisë, dhe të diasporës e deri në Indinë. Në tokë e në qiell Familja Bojaxhiu përbën hartën më të vërtetë të Shqipërisë etnike. Dranja e Gjakovës, Kola i Prizrenit. Ageja, Lazri e Gonxhja të Shkupit ku edhe prehet Kola. Ndërsa në varrezat e Sharrës në Tiranë pushojnë në amshim Dranja e Ageja. Përtej detit atje në Palermo të Sicilisë pranë shumë arbëreshëve pushon në përjetësi Lazër Bojaxhiu. Ndërsa në Kalkutë të Indisë prehet bija më fisnike e racës arbërore Nëna Tereza.

Për Kolë Bojaxhiun nuk janë bërë studime të mjaftueshme nga historianët shqiptarë. Natyrisht se, serbët i kanë humbur ndoshta të gjitha gjurmët e veprimtarisë së tij. Por mbase ka mbetur diçka në arkivat historike të Serbisë dhe vendeve të tjera ku veprimtari i Kolë Bojaxhiu punoi tërë jetën për të mirën e çështjes shqiptare dhe në fund këtë veprimtari sublime e pagoi me jetë. Vdiq në mënyrë misterioze në dekadën e dytë të shekullit XX, në kohën kur u vranë shumë patriotë shqiptarë nga forcat anti-shqiptare të Ballkanit. Nëna Tereza ka treguar gjithmonë për atdhedashurinë dhe humanizmin e tij. Ai kishte ndikuar më shumë se kushdo tjetër në veprimtarinë supërnjerëzore dhe të shenjtë. Kolë Bojaxhiu është babai i bijës më të mirë dhe më të njohur i të gjitha kohërave. Do të ishte në nderin e historianëve shqiptarë të bënin kërkime të mjaftueshme për ta vendosur atje ku meriton. Të gjithë kemi detyrime për Kolë Bojaxhiun dhe familjen e tij, por Shkupi, Prizreni e Gjakova kanë më shumë obligime. Rrugët dhe sheshet me emrin e tij do t'i nderonin qytetet dhe vendet e banuara shqiptare. Ky patriot e humanist meriton shtatore e nderime kudo. Nesër ndokush edhe mund të pyes kush është ky burrë shqiptar? Përgjigja është e lehtë! Ky është Kolë Bojaxhiu, babai i Nënës Tereze.

Marre nga revista
"Ëndrrat shqiptare"
e date 10 qershor 2013.
Adresa: www.albdreams.net



Gjurmëve të lashtësisë së fshatit Gjuraj

Reportazh

Duke e parë në gjithë ato angazhime në Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini", duke e parë qëndrimin e tij, korrektësinë dhe gjithë atë energji pozitive në këshilla e biseda me njerëz, nuk ke e si të mos e respektosh Ndue Sanajn. Ai disa herë ka ardhur në Kosovë ne krye te perfaqesueve te Shoqates "Atdhetare-Dukagjini", në kuadër të veprimtarive të përbashkëta me Shoqatën e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" dhe prezenca e tij bënte që të tejkaloheshin lodhja dhe ndonjë shqetësim.

Ndou, kësaj radhe bashkë me Vatën e Anton Kosterin në Kosovë kishin ardhur duke përcjellë gjurmët e lashtësisë së fshatit Gjuraj. I palodhur ky njeri i mirë i shtrroi vetit detyrë t'i vë në letër e t'ua lë brezave të dokumentuar historinë e pasur të fshatit Gjuraj. Mbase, kur kishte nisur këtë mision kishte menduar se është gjë e lehtë kjo, por i doli bukur shumë punë. I doli se mbiemri Gjuraj qenka i përhapur, jo vetëm në Shqipëri e Kosovë, po edhe në Spilit të Kroacisë e besa edhe në shtete tjera të Evropës e botës. Punë shumë, por Ndue nuk ndalet. Vazhdojnë në kërkim të gjurmëve të lashtësisë së Gjurajve.

Kësaj radhe në rrugëtim bashkë me Ndoun, Vatën e Antonin jemi edhe unë, Ukshini, Beka e Frashëri. Caku i parë është një fshat malor ca kilometra nga Peja e drejt kufirit me Malin e Zi. Atje, ne Radac një lagje e tërë mbanë mbiemrin Gjuraj. E gjemë këtë lagje dhe takohemi me njerëz e me mikpritjen vëllazërore, ne mes te cileve, me Imer Azem Gjuraj. Interesante ishte se ne ketebrajon ishin dy toponime, me emrin "Gjura", si: Bregu i Gjurajve dhe Bjeshka e Gjurajve. Ndue nis qetazi bisedën dhe nuk lejon t'i ik as edhe një fjalë e bashkëbiseduesve. Bukuria e natyrës këtu i shton hijeshinë këtij takimi. Flasin këta njerëz sikur të ishin njohur me vite. Koha

e kufizuar na bën që të largohemi nga ky fshat. Duhet të takohemi në "Gold" me furrtarin e njohur këtu e që mban me krenari mbiemrin Gjuraj.

- Të shohim ky Isufi sa po na ndihmon me fakte të reja për të gjetur edhe dikë

po lexoja gëzimin se po gjente gjëra me vlerë për librin e tij, që do e botojë e do ua lë dhuratë brezave.

-Shkoni në fshatin Gërçinë e takohuni me Rrustemin e Sokolin. Ata janë Gjuraj dhe dinë më shumë për historinë tonë, na

bëheshim gati të ndaheshim me Sokolin e Rrustemin, po ishte punë që nuk bëhej. Rrustemi Nduen e shihte me sytë prej një vëllai e mua më njohu nga Sindikata.

- Nuk shkoni dot nga këtu o vëllazër pa



Ndue Sanaj e Imer Azem Gjuraj



Ndue Sanaj, Rrustem Gjuraj, Rahman Jashari, Ukshin Jashari dhe larte Vat Gjoni, Sokol Gjuraj, Brka e Anton Kosteri

që e di historinë e fisit të tij, flet Ndue e ne urojmë që të gjejmë edhe diçka të re për notesin e Ndue Sanajt. Isufi na pret vëllazërisht dhe kur u hap biseda u bë pjesë e saj. Foli lirshëm për mbiemrin e tij dhe e tregoi se ka dëgjuar shpesh nga pleqtë se ata kishin gjenezën në një fshat me emrin Gjuraj.

- E kemi ruajtur që moti e brez pas brezi këtë mbiemër për të kujtuar ven-

thotë

në ndarje Isufi. Ndarja ishte vëllazërore. U përshëndet me ne edhe mësuesi Muhamet Shala nga fshati Loxhë. Ai gjatë gjithë kohës ishte bërë pjesë e bisedës dhe interesohej për fshatin Shalë të Shqipërisë.

Antoni mori bashkudhëtarët e tij. Disa kaluan në makinë e Bekës dhe u nisem drejt fshatit Gërçinë të Hasit. Rrugës bisedën na e kishte heshtur bukuria përrallore e natyrës. Pyje plot jetë dhe një fshat i ndërtuar e në hap me kohën. Rrustemi e Sokoli takohen me Nduen e me Ukshinin dhe nisin bisedën ashtu si vëllai me vëllain. Unë, Vata, Antoni e Beka sikur druhashim mos po e trazojmë këtë bisedë dhe prandaj zumë vend jashtë për të bërë ndonjë humor e për t'u kënaqur me gjithë atë bukuri të natyrës që Zoti i kishte falë këtij fshati. Na mahniten ato pamje dhe ec e mos bëj dhjetëra fotografi. Ndue kishte përfunduar bisedat fillestare dhe na ftuan të bëhemi bashkë në një tavolinë me gjithë të tjerët. Notesi i Ndues kishte fituar rëndësinë. Aty tani po rrinin fakte për librin. Ne po

ardhur në shtëpinë time e pa pushuar pak. Jemi vëllazër bre, tha Rrustemi dhe ne e kishim kot me lutjet e arsyetimet tona se nuk kemi kohë e se duhet të udhëtojmë. Rrustemi na priu dhe ne të gjithë bashkë u gjendem në një dhomë të bukur burrash. Pritje e biseda vëllazërore u zhvilluan aty. Pimë kafe e ngritem dolli me një raki, që nuk e kisha parë kurrë me parë. Pritonim të ndaheshim me Rrustemin dhe Sokolin. Më në fund u nisem. Kur dolëm në rrugën drejt Prizrenit makinat u ndalen. Beka i tregoi Vatës se dëshiron ta vizitonte fshatin Bogë atje në Shqipëri, sepse edhe fshati i tij në Kosovë ka këtë emër. Vata e fton vëllazërisht për vizitë. Ndue në ndarje i dha Ukës ca ekzemplarë të gazetës "Dukagjini" dhe dy shishe të rakisë, që i kishte sjellë për dy vëllazërit e tij. Ta them të vërtetën ai kishte me vete tri shishe, po njërin e kishte sjellë për ta ngritur dollinë me vëllazërit e miqtë e tij të shumtë në Kosovë. Vëllazërit u përshëndetën duke uruar që Ndue Sanaj të ketë mbledhur edhe ca fakte më shumë për librin e tij, botimin të cilit mezi e presim të gjithë.

Rahman Jashari



Ukshin Jashari, Ndue Sanaj, Muhamet Shala, Vat Gjoni, Isuf Gjuraj dhe Rahman Jashari

din nga i kemi të parët, thotë bindshëm Isufi e Ndues i bëhet qejfi. Në sytë e tij

DEMOKRACIA DHE LIRIA PO I TJETËRSON DISA NGA SHQIPTARËT

(Reagim i Shoqatës "Martin Dreshaj", lidhur me rrjedhat e fundit mes nesh)

Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" bashkë me gjithë veprimtarët e saj kudo në trojet etnike ka bërë gjithë angazhimet për të mbajtur gjallë vlerat nacionale e atë vrullin e nisur nga Rilindësit tonë për unitetin e vëllazërinë mes besimeve. Në vitet e vrara të Kosovës ishim bashkë dhe po ia shëronim plagët Drenicës, Rrafshit te Dukagjinit, Llapit e Gollapit. Armikun e njëjtë e kishin edhe Hasani, Rrustemi, Beka edhe Predi,

Martini, Kola ... e ai ishte fashizmi sllav që po mbillte vdekje e tmerr kudo në trojet etnike. Në një front ishin bërë shqiptarët për t'i mbrojtur trojet nëpër shekuj dhe kur erdhi demokracia dhe liria nisi t'i tjetërsojë shqiptarët. Kjo gjendja sot, më detyron të shtroj pyetjen se, a ishin gjallë këta shumë katolikët e shumë myslimanët në vitet e tmerrshme të okupimit? Nuk ishin se nuk i pamë as në mbrojtje të shkollës shqipe nga pushtuesi serb e as në betejat e mëdha e të lavdishme për liri. Ata demokracia e liria i nxori nga nëntoka dhe tash në emër të Konventave Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut nxjerrin gjuhët plot helm dhe flasin e mbjellin ndarje e përçarje dhe nuk kan asnje fije turpi kur thonë se, janë në mbrojtje të identitetit nacional?!

U duhet thënë këtyre njerëzve se, ne

jemi shqiptarë e se, besimet i kemi marrë sipas dëshirës a frikës, por kemi mbetur prapë shqiptar. U duhet thënë se Gjergj Kastrioti, Gjo Dedë Luli e Mehmet Shpendi, Ismajl Qemajli, Isa Boletini, Mic Sokoli, Ymer Przreni, Çerçiz Topulli, Dhaskal Todri, Pandeli Sotiri, Naim Frashëri, Adem Jashari e gjithë këta emra, që historia i shkëlqeu në ar janë shqiptarë dhe se e kanë mbrojtur idealin e atdhetarëve nëpër shekuj. Ata bashkë me bashkëveprimtarët e bashkëlufetarët e tyre kanë dhënë betimin para flamurit tonë nacional dhe janë gjetur në qendresa duke kërkuar lirinë e atdheut. Në kohën kur armiqtë po vazhdojnë me Programet për zhdukjen e çdo gjëje shqiptare, mes nesh po hapen tema mjerane se, kush është më fetar se tjetri duke mohuar shqiptarinë. O njerëz në shërbim të huaj,

mos punoni kundër shqiptarise, për ato pak para të pista që po merrni nga armiqtë, që nesër po u erdhi dita do u vrasin e tretin në fundërrina se, ata po ju përdorin sa iu duheni.

Dy shtete shqiptare duhet të shikojnë realisht aktualitetin dhe t'i qetësojnë ca njerëz, sepse po shihet se demokracia dhe liria po i tjetërson disa prej shqiptarëve. Ne, duam të mbesim shqiptarë e nuk kemi as edhe një arsye të bëhemi as më katolikë se Papa e as më myslimanë se kryeimamët.

Rahman Jashari
zëdhënës dhe koordinator
i Shoqatës së
Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe
"Martin Dreshaj"

RITI I LINDJES SË FËMIJËS

Martesa është mbjellja e farës në ugarin e jetës, lindja e fëmijës është ripërtëritja jetës, dhe gëzimi më i madh i prindërve, familjes dhe gjithë rrethit shoqëror.

Lindja është evenimenti themeltarë në jetën e fafesisit e të bashkësisë krahinore e sidomos në mënyrë të veçantë në shtëpinë dhe fisin e burrit. Lindja e fëmijës sidomos e djalit ka bënë një ngjarje jashtëzakonisht e hareshme e shoqëruar me zakone e rite sa spektakolare aq edhe interesante, të cilat hellin dritë mbi tiparet e qarta etnografike të unitetit krahinor të dukagjinës dhe të kaluarën e tij historike. Riti i lindjes së fëmijës është një vitrinë transparent ku gjenden të mishëruara, mendimet, shpirti i popullit, ndjenja e kompaktësisë, prirja për përparim, dashuria për jetën, vitaliteti dhe besimi optimist për një të ardhme më të mirë. Gjithkund, në Dukagjin familja e djalit, preokupohej shumë, jo vetëm për të martua djalin, por edhe për të gjete një mik të mirë, që të mos mundej kush me ja përgojua (të mos turpërohej fëmija) për dajën e vet, qoftë për emrin, trimin, bujari, burri e te tjera. Vajza duhet të jetë nga një derë e fisme, sepse djali ose çika që do të lindin, u ngjet dajave.

Jo më kot perifrazohej aforizma: "Nusja e sojshme o të len djalin, o fjalën e mirë e qet!" Në qoftë se dajat nuk janë të sojshëm, d.m.th trima bujar, besnik, mikpritës, punëtorë e te tjera, atëherë edhe fëmija nuk ka, ka shkon pa u ngjare dajave dhe, në vend që familja e burrit të ripërtërihet e të lartësohet ajo shkon drejt teposhtës, sepse mashkulli i keq veç fike e turp bien në vatër, në katund dhe në fis. Burrat e ditshëm të Dukagjinit thoshin: Njeriu përpara se të mbjelli arën duhet të di të zgjedh mirë farën që i jep bereqet! Martesa nuk bëhet sy mbjellur, pasi një fëmijë nga një derë e pa sojshme ta len zhigun e keq prapa që nuk të hiqet për 5 faqe rob. "Miku i ngjet mikut shumë kohë përpara", prandaj familjes së djalit, po s'i pëlqyen "okët" (soji i mirë) i familjes së vajzës nuk e

kërkonte atë për fejesë. Kështu edhe në Dukagjin si kudo në malet e kanunit, më parë gjendej miku dhe pastaj informohej për vajzën. Paraqitja dhe bukuria e vajzës ishte në plan të dytë, kurse sjelljet dhe përgatitja për jetën mbeteshin gjithmonë primare. Në Dukagjin çmohej shumë gruaja punëtorë si krahu i djathtë i burrit për të mbajtur shtëpinë, prandaj thonë: (Burri banë e bjen si dai / Gruja të ban shpi - Pa grue s' çilet dera - Nafak ma-

dhi vdes vetë; nafak ziut i vdes gruaja e te tjera). Në të kundërt, gruaja dembele konsiderohej e rende, si "fikekonakë". Në se femrës së hijshme, punëtorë i është kënduar gjithë sharmë e respekt, në antitezë të plotë me satirë dhe ironi i është kënduar gruas dembelisë, të pa rregullt e jo pastërtore.

Moj e mirë që shkon në krue / Themrat jashtë buljerën shbutue / Moj e mirë me të tana të mirat / T'ue nda shtalbin e t'ue fshi qyrrat / T'ue gatue e t'ue lidhë tlinat ... / Fort përton me u çue prej shtratit / Të lëvrinë strepat në shekat dja-thit



Nuse motit

Lindja e fëmijës qëllimi primare i martesës

Gjatë gjithë kohërave, lindja fëmijës në popull është konceptuar si qëllim i



Adaptimi i fëmijëve

martesës, për të siguruar vazhdimësinë e jetës, krahët e punës si instrumenti për të rritur e forcuar familjen dhe fisin. Kur martohej çifti, familjen e dhëndrit e uronin: "Nusja të pastë ardhë me nafakë!". "Djali jua gëzoftë nusën!" Pjelloria e gruas në meshkuj shikohej me sy të mirë, konsiderohej nafakë (fat) si diçka shumë të rëndësishme në jetën e familjes, nuk ndodhte kështu kur lindin

vajza, pasi vajza thuhej le për derë të huaj. Kur çifti nuk lindte trashëgimtar, ata quheshin "të panafakë". Pa dituria dhe meskiniteti patriarkal i kohës njihje si shkaktare të shterpësisë vetëm gruan. Kur kjo nuk lindte fëmijë, familja ishte shumë e shqetësuar, autoriteti i saj në familje nuk ishte si një nënë tjetër. Për gruan që nuk linte bësheshin shumë përpjekje si nga ana e sajë ashtu edhe nga vjehrra. Në të kaluarën ka pas disa gra të veçanta që merreshin me ketë zanate. Ato quheshin "ngjeshatare". Gruas që nuk lindte kur mendohej se i janë ftohur vezët, ngjeshatarja ia fërkonte barkun me tëlyen ose vaj ulliri, ndërsa kur mendohej se është vrrarë "ani i fëmijës" ose është kthye mbrapsht, ajo merrte një monedhë metalike e mbështilte mbi një pece të lyme me vaj guri, ja vente mbi kërthizë dhe i jepte flakë e mbi të vinte një vorbë prej balte dhe menjëherë, duke fërkua barkun, vorba ja tërhiqte përbrenda, Ky ritual përsëritej tre ditë me radhë dhe mbasi ja tërhiqte vorbën, ja lidhte barkun me një shokë (brezi) burrash prej leshi dhe mbi të i vinte një tullë të nxehtë. Të shumta kanë qenë rastet që kanë dhënë rezultat pozitiv "ani i fëmijës" vente në vendin e vet dhe gratë më pas mbeteshin me barrë dhe bënë fëmijë¹ Fati i lindjes besohej se ishte në dorë të Zotit, prandaj njerëzit vazhdimisht i luteshin atij. Kur shpresat veniteshin nga dështimi i këtyre provave gratë shkonin edhe tek fallxhoret, që gjendeshin jashtë Dukagjinit, për të pyetur nëse do të bënin fëmijë apo jo. Në këtë rast veprimi ishte në kundërshtim, me të drejtën kishtarë, (falli është mëkat i dënueshëm), por dëshira e madhe për t'u bërë nënë i bënte gratë trime të flaknin tabunë e ndaluar dhe të zbatonin recetat "magjike" të fallxheshave. Edhe kur çifti nuk bënte fëmijë, bashkëshortët nuk ndaheshin e si rrjedhim nuk bëhej ndonjë martesë tjetër.

Kisha e mbështetur në unison nga kanuni në mënyrë më stoike nuk lejonin martesë të dytë as poligaminë në asnjë nga fiset katolike të veriut. Divorci dhe shkurorëzimi nuk lejohej nga kisha, çdo martesë e dytë quhej martesë në gjynah (mëkat), nuk kurorëzohej, madje as fëmijët që do lindin në krezmoheshin, as të ligjoheshin në kishë. Gjithsesi në disa raste kur gruaja nuk lindte ose lindte vetëm vajza, me qëllim që të mos shuhej hisja, në kundërshtim flagrant me ligjin kishtarë, dhe forcën e opinionit shoqëror, janë bërë martesë të dyta. Burri në këto raste merrte edhe me pëlqimin gruas së parë duke e mbajtur njëkohësisht edhe atë pranë vetës. Deri në vitet 30 të shekullit 20-të Kisha në çdo rast ka mallkuar

publikisht çdo martesë të tillë si mbeturinë poligamie. Mëkatari kisha i bënte lutje, të hiqte dorë e të kthehej në rrugën Zotit. Kur i pa binduri, qëndronte me kokëfortësi në vendimin e tij, atëherë Prifti në mesha të posaçme në prani të gjithë besimtarëve të fisit lëshonte mallkimin publik: *Mallkue qoftë filani për martesën në gjynah me filanen! Mallkue qoftë filani që shkeli me pa besë sakramentin kurorës së shenjtë të lidhur përpara altarit në besëlidhje e me bekimin e Zotit! Martesa e tij jashtë kunoret është në kundërshtim me një prej 10 urdhesave të Zotit. Që sot e për gjatë mot filani ç' kishërohet: As ai, as grueja dhe fëmijtë që mund lindin jashtë kunoret nuk kanë vend në shpinë e Zotit.* Në disa raste predikatori mallkues kalonte deri në ekstreme të tilla duke interpretuar skena rrenqetshme përpara qindra besimtarëve: *Vëllezër dhe motra besimtarë siç po fiket tani përpara jush ky qiri (merrte qirin dhe e fikte në ujë). U fiktë hisja e filan mëkatari ...! Aq fuqi sugjestionuse kishte ky ndëshkim sa besimtari i atëhershëm mendonte se një mallkim i tillë ligështonte edhe gurin.* Fëmijët që lindnin nga martesë të tilla, shiheshin me keqardhje si fëmijë gjynahut, të rrishtuar nga fati jo i mirë. Është djalë i mirë, por ka le në gjynah, thuhej duke nënkuptuar se nuk ishte i krishterë!

ADAPTIMI I FËMIJËVE

Në malësitë tona ka ekzistuar edhe rasti i adoptimeve. Zakonisht adoptoheshin fëmijët e vëllait, ose të motrës, ose të ndonjë të afërmi tjetër. Në raste të tilla parapëlqehesh më shumë djali se vajza, se djali "shtonte hise, njerëzit dhe derën e shtëpisë e mbante hapur", ndërsa vajza ishte e përkohshme në shtëpi. Për edukimin e vajzës gjithnjë kushtohej kujdes më i madh me qëllim "që ajo të mos linte marre prapa në konak". Vajzat e mira e të edukuara ditën e martesës gjithmonë uroheshin: Doli nuse me fjalë të mirë! Ja priftë Zoti mbarë ku do që të vëntë këmbën! Fëmija i falur quhej "djalë i falur ose vajzë e falur"

Po ta fali djalin (vajzën) i thoshte i afërmi-të afërmit. "N' dorë tande e n' dorë t' Zotit. Prej teje due me ma dashte e hatrue si me këndë i yti". Adoptuesi betohej "Do të kujdesëm ma shumë se me kenë i jemi. Nuk do ta la mejmungue, veshë as mbatha, heja, as pija, dashnia as lezeti. T'i më fale loçkën e zemrës sate, prandaj të faleminderit! Fëmijët i paç me jetë e ti ruajte Zoti!" "Kjoshin jetëgjatë me nanë e me babë!" "Edhe ju i paçi me jetë, uronte familja që falte djalin ose vajzën. Në përgjithësi, adoptimi bëhej në moshë të vogël, pasi fëmija i ishte shkëputur nga gjiri i nënës dhe shpesh i adoptuari nuk e mësonte kurrë të vërtetën e adoptimit të tij. Adoptimi bëhej edhe në moshë të rritura. Kur fëmija e merret vesh se ishte i adoptuar, shpesh ftohej me adoptuesit, madje nuk kanë munguar as raste kur fëmija largohej fare pa ndonjë shkak bindës. Në raste të tilla ertësia proverbiale nënvizonte si kryefjalë: "Fëmija i huaj kurrë nuk bëhet i yti!"

Prellë Milani

1 - Informatore Drande Gjelošhja nga fshati Pepsuj Shosh 90 vjeçare.

BESA E KONSTANDINIT TË MADH E SOLLI PËRSËRI DORUNTINËN NË NAISSUSIN DARDAN



Reshat AVDIU,
Presheve

Tash e shumë vite më parë ndër popullatën shqiptare në këtë pjesë të Dardanisë Lindore flitet për Besën e Madhe të Konstandinit nga Nishi, që ia kishte dhënë motrës së tij Doruntina Naissusit. Të cilën e kishte martuar shtatë konaqe larg nga Nishi. Duke e pajtuar dhe ngushlluar se për çdo motmot do të shkonte dhe merrte motrën e vet dhe sillte në gjirin e saj familjar.

Luftëra dhe hata të mëdha kishin ra atëbotë mbi trojet dar-

dane nga të huajt. Në njërin nga ato beteja të shumta kishte ra edhe vet Konstantin i Madh. E për Doruntinën kishin filluar të zgjateshin, e të zgjateshin, pa kufi stinat dhe motet e mërziisë dhe brengës për vëllanë, nënën për ato fusha dhe lendina të blerta në Naissusin e saj të lindjes.

Ç'do mëngjes pranveror ajo dilte tek ata dy lisat e mëdhenj mbi kodrinë për ta pritur vëllain e saj se mos po i vinte atje nga Dardania e largët me kalin e tij të shpejt si shiqeta. Kot vëllai i saj nuk vinte se nuk vinte dot, pastaj së beshku me qyqet e malit ia fillonte vajit dhe kujës për Konstandinin dhe nënën Helenë e mbetur edhe ajo si qyqe në rrem në fronin e të birit të saj në Mediana*** të Naissusit. Edhe nëna e saj e priste të bijën e vet se mos po i vinte sa për ta parë dhe ngushlluar për Konstandinin e Madh. Sytë iu kishin verbuar nga vetmia dhe lotët e ditëve dhe netëve në vi-

jim.

Një ditë si zakonisht përsëri Doruntina kishte dalë tek ata dy lisat e mëdhenj për ta pritur vëllanë e saj. E diku atje larg përtej fushës së gjërë dhe katër maleve shqiptare dukej si nëpër mjegull një kalorës që e ngiste kalin e tij si shiqeta ai sa vinte ofrohej e ofrohej. Hej! Zemra e motrës së shkrëtë filloi t'i rrihte, e t'i rrihte, vrullshëm e më vrullshëm saqë donti t'i dilte nga kraharori. Vallë a mos do të jetë vëllai i motrës?! Po, po Konstandini ishte vet, ishte ngritur nga varri dhe kishte ardhur për ta marrë motrën e tij, dhe për ta çuar në vend Besën e Madhe Shqiptare. Doruntina e kishte kuptuar se me vëllain e saj nuk ishte diçka në rregull, s ishte më ai Kostandini i fuqishëm që kur qëllonte me topuzin e tij të madh bënte që edhe bjeshka të dridhej! I vinte erë dheu, sytë i kishte të shteruar dhe të venitur, fytyra e tij dyllë e verdhë, flokët e gjata e të shpupurishura, duart e ftoh-

ta si akulli, plisi dhe guna e tij e baltosur me opinga të grisura. Kështu dukej kalorsi nga Dardania e largët.

Koha ishte të niseshin për ate rrugë të largët të Egnatias për në Naissus. Kur po i afroreshin shtëpisë së vjetër, Konstandini i thotë motrës së tij, hec motra ime, hec përpara, sa ta lidhi gjokun për trungun e Mollës së Kuqe! Nga ai moment Konstandini i motrës, së bashku me erën e fortë që kishte filluar të fryente, e të fryente ate pranverë të vonuar, humbi dhe nuk u duk më!

Doruntina si një verkë mbi valët e detit të tërbuar drejtohet për në votrën e nënës Helenë. Ate të shkrëtë e gjeti të ulur skaj oxhakut duke vajtuar për të bijën e saj Doruntinën dhe djalin Konstandin Naissusin i vrarë ndër beteja të shumta me bajlozët dhe invadorët huaj që vinin atje përtej detit për t'i mësyer këto trojet tona dardane.

Nënë, nënë, jam bija yte Doruntina! O Zot, a mos jam në ëndërr, a mos po tallet ndokush me mua plakën e shkrëtë dhe të verbër. Jo moj nënë, jo, Konstandini, Konstandini... vëllai i motrës erdhi dhe më morri e më solli këtu! Mbeti pak larg shtëpisë sa për ta lidhur kalin për trungun e Mollës së Kuqe të

Naissusit.

Jo, e shkreta moj bijë! Konstandini vëllai yt, ka vite që ka vdekur edhe varri tij gjer më tani është rrafshuar për tokë nga stina dhe moti. Ah, moj e gjora nënë, Besën e Madhe Shqiptare që nga Troja jonë e lashtë e gjer më sot nuk po e treti dot dheu as nuk po e thanë dot dielli dhe as nuk po e merr dot dallga e detit... Ajo është ngulitur thellë në mendjen dhe shpirtin e ç'do shqiptari, pra edhe Besa, e Konstandin Naissusit do të jetojë, e do të jetojë ndër mote...!

P.S.

*** Në vitin 330 e.s., Mbretëresha Helenë vdes dhe varroset në Mediana të Naissusit, në Fronin e të birit të saj, Shën Kostandit të Madh. Ky vendbanim Iliro-Dardan, gjendet sot mes Nishit dhe Banjës së Nishit, gjegjësisht Ilixhës së Nishit. Helena ishte e një shtrese shumë të ulët, e cila u martua me Konstancë Klorin. Pas kësaj ai u nda nga Helena, pasi u detyrua ta merrte për grua vajzën e Maksimilianit, Teodorën. Kostandini ishte pak i shkolluar dhe ishte peng te Diokleciani dhe Galeri në kohën e sundimit të tyre ai luftoi me trimëri.

Përurohet www.adsh.unishk.edu.al Arkivat Digjitale Shkodër

Ditën e mërkure, më 19.06.2013, në orën 18.00 u zhvillua në sallën "Walter Höflechner" të Bibliotekës Universitare, aktiviteti promovues i faqes elektronike www.adsh.unishk.edu.al - Arkivat Digjitale Shkodër. Ky aktivitet u organizua nga dy bibliotekat: ajo publike "Marin Barleti" si dhe nga Biblioteka Universitare.

Pjesëmarrës të këtij takimi promovues ishin Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, Rektori i Universitetit të Shkodrës Prof. Dr. Artan Haxhi, përfaqësues të pushtetit lokal, përfaqësues nga D. A. R. Shkodër, profesorë të Universitetit "Luigj Gurakuqi", punonjës të bibliotekave të Shkodrës e të tjerë.

Fjalën e hapjes e mbajti drejtoresha e Bibliotekës Universitare, Alida Luka, e cila prezantoi ligjëratën e saj "Nisma dixhitale në Bibliotekën Universitare". Znj. Luka, pasi bëri një historik të shkurtër rreth punës së kryer, vuri theksin në mbështetjen e marrë nga autoritetet drejtuese të Universitetit "Luigj Gurakuqi", të cilët mundësuan realizimin e kësaj nisme bashkëkohore. "Kemi një aksesim tek këto materiale me vlerë të trashëgimisë

tonë kulturore, tashmë jo vetëm për studiuesit por edhe për lexuesit e thjeshtë që duan të njohin rrugën e përshkruar nga kombi ynë në shekuj. Ky është vetëm fillimi, pasi Shkodra ka shumë për të treguar dhe ekspozuar" - u shpreh znj. Luka.

Drejtori i Bibliotekës Publike



"Marin Barleti", Gjovalin Çuni, në ligjëratën e tij "Arkivi dixhital, qasje e re e trashëgimisë kulturore" theksoi rëndësinë që ka nisja dhe perfeksionimi i mëtejshëm i këtij hapi që u hodh në arkivimin dixhital, pasi kjo rezultoi të jetë një ndër mënyrat më të duhura për t'iu qasur sot ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

Në këtë takim u prezantuan edhe ligjëratat të tjera: "Dublin Core dhe skeda dixhitale" nga Olimpia Kakarriqi, përgjegjëse e fondit Albano-Balkanologjik, "Menaxhimi i arkivit" nga Sidita Halluni, IT (Biblioteka "Marin Barleti"), "Teknologjitë e përdorura në Arki-



vat Dixhitale" nga Gjergj Sheldija, IT (Biblioteka Universitare).

Në vijim të takimit, kryeparlamentarja Topalli e përshëndeti aktivitetin dhe iniciativën e dy bibliotekave në krijimin dhe mirëmbajtjen e këtij website. Z. Topalli, përmes vlerësimit që i bëri punës së kryer deri tani, i siguroi aktorët

veprues të kësaj nisme se do të kenë mbështetjen e nevojshme për një perfeksionim të vazhdueshëm të saj dhe bashkëpunim me Bibliotekën e Kuvendit të Shqipërisë.

Në mbyllje të takimit, znj. Luka ftoi institucionet kulturore që t'i bashkohen kësaj nisme duke ruajtur të drejtën e editorit. I gjithë materiali i digjituara dhe i hedhur në këtë website do të ketë si administrator Bibliotekën Universitare. Gjithashtu, ajo falënderoi bashkëpunëtorët dhe në mënyrë të veçantë kryeparlamentarën znj. Topalli për pasurimin e fondit të albanologjisë me kolanën: Bisedime Parlamentare 1920-1939, si dhe me librin

stat "Cirka", "Agimi", "Përpjekja", të gjitha këto nën etiketën e Bibliotekës Publike "Marin Barleti". Ndërsa, revista "Leka" si dhe 47 librat e hedhur në këtë faqe, janë në pronësi të Bibliotekës Universitare. Përmendim disa tituj: "Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut, princ i epiritëve" i Marin Barletit, librin "Përmbledhje e shkurtër e "Doktrinës së Krishterë" i Gjon Nikollë Kazazit (kopja e vetme në Shqipëri), "Rrethimi i Shkodrës" i Marin Barletit, "Doktrina e Krishterë" e përkthyer në shqip nga Pjetër Budi, Kronikat turke e të tjerë. Shfletimi i materialeve mund të bëhet përmes disa mënyrave: sipas llojit të materialit (gazetë, revistë, libër), sipas subjektit (gjuhësi, gjeografi, histori etj.), sipas datës (viti të botimit të materialit përkatës), sipas pronarit të materialit etj. Tani për tani, në këtë arkiv digjital janë të hedhur libra e koleksione periodikësh që janë në pronësi të Bibliotekës Universitare dhe Bibliotekës Publike "Marin Barleti". Perspektivat janë për zgjerim të bashkëpunimit mes disa bibliotekave.

Synimet e faqes elektronike www.adsh.unishk.edu.al janë ruajtja e trashëgimisë kulturore përmes koleksioneve virtuale; krijimi i një sistemi bibliotekash digjitale në qytetin e Shkodrës përmes një bashkëpunimi edhe më të gjerë, duke respektuar gjithnjë standardet ndërkombëtare; lidhjet e bibliotekave me rrjetet e shpejta të kërkimit etj.

Arjeta Ferlushkaj

JO GJAKMARRJES, SËBASHKU PËR JETËN

ALTIN NIKA,
Aleanca për Jetën

Edhe këtë vit, si çdo vit tjetër, me 14 Qershor, në Ditën Ndërnacionale të Dhurimit të Gjakut u ndërmor nisma nga disa organizata JOQ-ve, të grupuar në "Aleanca për Jetën" për marshimin me titull aq të bukur po aq e ndjeshme "Jo gjakmarrjes, se bashku me jetën". Qetësinë e qytetit apo rutinën e përditshme e theu muzika dhe ecja plote kuraja dhe dëshirë për jetën e pjesëtareve të

keqe të na bëj të ndjehemi keq: "Do ta çrënjosim, ta zhdukim përfundimisht nga shoqëria jonë, e ajo do të mbetet një kujtim i lig nga e kaluara!".

Marshimi filloj në orën 10:30 nga Sheshi "Nene Tereza", monumenti i Nene Terezës, nga kjo Nene e Madhe e dashurisë për njeriun dhe e Paqes për të vazhduar me tej në shëtitore para Institucionit të Prefekturës së Qarkut Shkodër-Godina e Bashkisë së qytetit- sheshi "Parruce"-Biblioteka "Marin Barleti"-Rektorati-Sheshi "Demokracia", Biblioteka "Luigj

Ajo çka vlen të theksohet është dhe akti i dhurimit të gjakut, nisme e koordinuar mirë mes Kryqit të Kuq Shqiptar dhe Aleancës për Jetën. Nuk mund të kishte kuptim, një nisme e tillë pa dhurim gjaku për të shpëtuar dhe jo për të marrë jete. Kësaj thirrje ju bashkuan disa qytetare të

qytetit tone, Shkodrës dhe mbi të gjitha, kishte një jehonë të madhe mediatike.

Do donim që të kishim me pak organizime të tilla, ku fenomeni i gjakmarrjes të jete thjeshtë një ëndërr e se kaluarës, por deri atëherë, kemi shumë për të bërë!



Aktori Tomas Delija, duke lexuar dhe interpretuar fjalën e hapjes së kësaj veprimtarie



Grupi i punës duke organizuar levizjen

shoqatave dhe komunitetit të Shkodrës.

Ajo çka theu heshtjen e bëri që aktiviteti të fillonte, ishte leximi i fjalës hapëse nga Tomas Delija, ku ndër të tjera theksoi: "Ishte një rastësi e kobshme që pikërisht me 14 qershor 2012, kur në protestonim kundër gjakmarrjes, ajo na goditi mizorisht duke marrë jetën e Maries. Ishte vetëm 17 vjeçe, nuk i kishte bërë kurrë keq askujt, dhe ëndrra e saj për jetën u këput në mes. Gjakmarrja e mori pikërisht atë ditë, si për të na thënë në "Kot e keni! Nuk më mundni dot!". Me pas mbylli duke theksuar e dhenë shprese se, ne, e mira do të fitojmë mbi të keqen që tashme nuk mund të vijojë me kjo e

Gurakuqi"-Sheshi "Truma" dhe vijojë neper shëtitoren e qytetit tone. Çdo hap që secili prej nesh në atë marshim hidhte, buçiste me një "Stop" të madhe ndaj gjakmarrjes, stop të madh izolimit të fëmijëve, me një thirrje drejtuar qytetit dhe ndërgjegjes qytetare dhe kolektive të secilit banor të tij.

Grupi organizator kishte kuruar gjithçka deri në detaje.

Në shesh secili prej njerëzve që kalonin mund të firmoste për të thënë "Jo gjakmarrjes" në grupin e firmëtareve. Si një vullë e pashlyer kuraje e force, për të dashur me shumë jetën, për të dashur me shumë njeri-tjetrin.



Pjesëmarrësit duke dale nga sheshi "Nene Tereza"



Punime nga fëmijet e ngjuar, duke shprehur revoltën ndaj pakenaqesise së strukturave të shtetit, për parandalimin e gjakmarrjes, për të mos lejuar burgosjen në shtëpi të tyre



Fillimi i marshimit neper rruget kryesore të qytetit tone



Kalimi i sheshit te "Parruces"



Vijimi i marshimit neper rruegt e qytetit tone (ne mes Prefktures e bashkise se qytetit)



Kalimi para bibliotekes "Marin Barleti"



Kalimi te sheshi "Demokracia"



Kalimi para bibliotekes "Luigj Gurakuqi"



Kalimi neper shetitore

POEZI *** POEZI *** POEZI *** POEZI

PENSIONISTI DHE KASTRAVECI

Pensionisti skuq si spec,
Jo prej shnetit, por prej tensionit,
Ballë për ballë me një kastravec,
U ndodh n' ditën e pensionit.

Kastraveci ngjyre jeshil,
I krekosun porsi gjel,
Ballë për ballë si karafil,
Pensionistin e fton n' duel.

A e din –thotë kastraveci,
Plot një kile peshoj sot,
Kalimtarëve ju buzëqeshi,
Kur e kanë kuletën plot.

Kurse ti more i shkretë,
Që gjithë jetën n' punë je shkri,
Asnjë lek s'të mbet n' kuletë,
Me ble pak prej shokëve t' mi.

Pensionisti i zanun ngushtë,
Në duel me kastravecin,
Fytyra e tij ma fort u skuq,
Kurrë më ngushtë se kish pa vetin.

Dhe u nis ashtu me vrap,
Prej inatit ndezun prush,
Kur përpara i del një krap,
Krapuliqi i ban një "dush".

A e din more rrezik zi,
Që me rrogë që merr në javë,
S'mundesh një prej shokëve t' mi,
Me fërgu, as me ba tavë.

E di mirë, tha pensionisti,
Krapi asht "mollë e ndalueme",
Ku tregtohen peshku e mishi.
Për ne asht "zonë e minueme"

MARK BREGU

E VËRTETA QË MË ZGJOI NJË KUJTIM



Dede Shkurti

Duhet të ishte rreth orës dy e mëngjesit të datës 28 korrik 1969.

Sapo kisha mbushur të gjashtëmbëdhjetat dhe ndodhesha në Jonufër, në aksionin kombëtar të rinisë. Fjetina prej më shumë se dyqind djemsh sapo kishte rënë në gjumë. Ca dhimbje të tmerrshme më kapluan të gjithë pjesën e barkut.

U ngrita pa bërë zhurmë, dola nga fjetina dhe trokita në derën e ambulancës. Mjeku u zgjua me një frymë, më shtriu në një minder, më bëri një qetësues dhe zgjoi shoferin e autoambulancës.

- Do të shkojmë në Vlorë, në urgjencën e spitalit - më tha me qetësi, - dyshoj në një krizë apendiciti.

Pas gjysmë ore u gjenda në urgjencën e spitalit të Vlorës. Krizat më vazhdonin me të njëjtin intensitet por, sa nga frika e sa nga kureshtja, po duroja pa bërë turr.

Mjeku kirurg me emrin, Servet Braka, filloi të më vizitonte duke më prekur në çdo cep barkun. Urdhëroi infermieret të më merrnin dhe të më bënin urgjent analizat. Tek po plotësonte kartelën e shtrimit filloi të më pyeste se nga isha, te dhënat e familjes e familjes, moshën ...

- Të paska zënë mirë dielli i Jonufrës. A ka lumë më fshatin tënd, a di not? Notohet më mirë në lumë apo në det?

Analizat erdhën më shpejt se ç'i prisja. I pa dhe më tha:

- Nuk më ka gabuar asnjëherë as syri e as veshi klinik. Ju duhet t'i nënshtroheni një operacioni!

Është apendicit peritonik! Më kanë thënë se mirditorët janë trima. Moshë dhe fiziku juaj, shumë energjike, do t' më bëjë të këndojë bisturia.

- A keni njeri të afërt në Vlorë?

- Jo, nuk kam. Unë nuk kam frikë. Ju lutem ndërhyini sa më parë të jetë e mundur të më pushojnë dhimbjet. Kurrë nuk më ka dhimbur barku, vetëm më ka grirë nga uria. Nuk dua të më shqetësoni as njeri, as nga familja e as nga shokët në aksion.

Dy infermierët e kishin sjellë barelën ... dhe ... më dukej se ndodhesha midis Jonit, dhe një peshkaqeni qe tentonte të më shqyente në ije. Luftoja me një kmesë me të cilën prisnim drizat me gjemba të Jonufrës. Pastaj një delfin i bardhë luftonte me peshkaqenin, pastaj ... mu bë se dëgjoja zërin e babait:

- Pse, si puna jote janë burrat, bërtet se të ka hy një ferrë në këmbë!

- Mos ma turpëro djalin, i hakërrehej nëna! ...

- Bravo, bravo, djali trim i Mirditës! Ja, ia hodhe si burrat!

- O, të keqen e syrit që ma paske si rrush! Lum ajo nënë që të ka more bir!

Hapa sytë si në për mjegull dhe mbi trupin tim pashë një fytyrë që nuk më ngjante me nënën.

Qe pak më e re, mbante në kokë një shami të bardhë dhe fliste me një toskërishte të pastër.

Në krahun tim të majtë pashë një serum të ngulur. Në të djathtë, një burrë i shëndetshëm më mustaqe, i rruar e krehur rregullisht dhe në moshën e babait tim. I mungonte vetëm kësula e bardhë.

Tentova të lëviz, por një therje e fortë në fundin e barkut dhe një rrip i lidhur në dy anët e krevatit më gozhdoi.

- Më jepni pak ujë, pashë Zotin e Madh! Po vdes për ujë! A mund ta di se ku jam dhe kush jeni ju që po më rrethoni?!

- O, cubi i Mirditës, - filloi të fliste me shaka burri me mustaqe, - të kemi mbërthyer si derrin e egër, nuk do të japim as ujë e as bukë. Më parë do të shërojmë. Ia hodhe si burrat! Doktor Serveti ta hoqi atë, zorrën e keqe, të qelbur!

Tavani dhe dhoma filloi të merrte formën në sytë e mi. Ndodhesha në pavijonin e Spitalit të Vlorës.

Nëna labe, mesa dukej, e ndonjërit nga të sëmurët e tjerë më vinte një napë të ftohtë mbi ballë të cilat i ndërronte çdo minutë. Dy infermiere, vajza të reja, vraponin duke i ndërruar garzat.

- Më thirrni doktor Servetin!

- Si urdhëron, drejtor! - vajzat infermiere vrapuan të zbatonin urdhrin.

- Hë, more ti, mirditor i fortë, si ndjehesh? Të kam bërë një operacion shumë të mirë. Infekcioni ta kishte kapur pjesën më të madhe të zorrëve. Të kam pastruar mirë dhe, për dhjetë ditë, do të shkosh tek tarracat!

Burri, të cilin i thërrisnin, Drejtor, filloi të fliste tamam me një siguri drejtori:

- Doktor Serveti, sonte do ta kalojmë natën bashkë. Do të rri edhe unë mjek roje me ju! Do ta nxjerrim së bashku nga gjendja pas operacionit këtë djalë. Ti do t'i bësh shërbimin si mjek, unë do t'i bëj shërbimin si prind, do të jem sonte si babai i tij. Ja, dhe nënën ku e ka, (bëri më shenjë nga nëna labe që po më mbante me kompresë dhe po më përkëdhelte).

Nuk po kuptoja asgjë. Mbaja mend se kisha ardhur me urgjencë për një dhimbje barku dhe kaq.

Drejtori filloi të më pyeste për emrin, moshën, fshatin, kë kisha në familje. Pastaj filloi të më bënte një provim gjeografie; të më pyeste për Suk' Munegën, Gëziqin, Ndërfanën, Qafëmollën ...

I përgjigjesha ngadalë por saktë, sepse gjërat i dija, ashtu siç m'i kishin mësuar prindërit dhe mësuat.

Pastaj më pyeti se çfarë dija për Luftën, kush e kishte çliruar dhe kur ishte çliruar Mirdita, kush kishin qenë Brigadat partizane që e kishin çliruar, kush ishin Heronjtë dhe dëshmorët e Mirditës.

Nëna labe dhe dy ndihmësmjeket vazhdonin të merreshin duke më stabilizuar temperaturën, ndërsa tek koka në dy anët ishin ulur doktor Serveti dhe Drejtori.

- Trimi i Mirditës, - filloi të fliste me një ton të ultë, ngadalë dhe me shumë siguri - unë jam Ibrahim Dërvishi, mjek dhe drejtor i këtij spitali.

Kam qenë partizan dhe kam luftuar, edhe atje, në Mirditën tënde. Që po rri këtu, tek koka jote, më shtyn jo lufta që kam bërë, por një ngjarje e pasluftës.

Akoma nuk janë mbushur njëzet vjet nga ajo ngjarje që nuk do të më shlyhet kurrë nga kujtesa!

Një orë larg shtëpisë tënde, në pyllin më lis të Ndërfanës unë, doktori i luftës, ish partizani, Ibrahim Dërvishi, kam plagosur një djalë mirditas njëzetetrevjeçar. Më dhanë urdhër ta plagos.

Unë isha mjek, shkollën e kisha mbaruar për të shëruar dhe jo për të vrarë.

Kur më thirrën dhe më thanë se duhej të bëja një plagosje, unë kërcëva në këmbë!

- A e dini se me kë keni të bëni? Më shkarkoni nga detyra, më çoni në burg, unë këtë urdhër nuk e zbatoj!

Ministri i Brendshëm, i cili ma dha këtë urdhër, qeshi:

- As nuk do të pushohesh e as nuk do të burgosesh! Personi do të plagoset me dëshirën dhe insistimin e vet. Ai ka plotësuar vetë kërkesën, deklaratën ku merr përsipër çdo përgjegjësi. Prej teje duam një plagosje të madhe, të dukshme dhe të padëmshme. I plagosuri nuk do të mjekohet e as të shtrohet në spital, por do të arratiset në mal i sapo plagosur!

Sot, pas nëntëmbëdhjetë vitesh, unë po trajtoj si mjek jo plagën e njëzetetrevjeçarit të bërë nga Naganti im, por operacionin e një mirditasi tjetër, gjashtëmbëdhjetëvjeçar që e ka operuar kolegu im.

U përkul dhe më puthi si një baba i dhembshur dhe pashë dy sytë e tij që kishin filluar të njomeshin nga lotët. Terapia vazhonte, nëna bënte punën e vet më kompresat dhe duke më lagur buzët, Serveti ishte gozhdur në karrige dhe ndiqte me shumë kërshebi bisedën e Drejtorit të tij:

- Tërë shkollën që kisha bërë, kisha mësuar se si ta shëroj një plagë dhe jo, si ta shkaktoj atë.

Hapa Atlaset mjekësore.

Për një moment u hodha përpjetë nga

gëzimi, e kisha gjetur vendin, një zonë e lokalizuar, pa kockë e pa shumë nerva dhe enë gjaku. I telefonova Ministrit dhe i thashë se e kisha planifikuar plagosjen dhe isha gati kur ta kërkonin.

Ministri, pasi dëgjo propozimin tim, më shfryu:

- Qenke një kokërr gomari që s'e paske shokun! Ai që do të plagosësh ti, nesër do të shpallet Hero i Popullit! Do të flasë e takojë njerëz, do të jetë e nevojshme ta zbulojë edhe plagën e tij! Pse more, tutkun, bythën do t'u tregojnë ai njerëzve!

Po mendoja një mënyrë tjetër kur ra telefoni dhe më thanë se do të nisesha urgjent për në Mirditë për të kryer "shërbimin" e caktuar.

Mëngjesi i asaj dite na zbardhi në pyllin e Ndërfanës. Ishim dy veta, unë dhe R. K., njëri nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Ministrit.

Tek vendi i caktuar, dëgjuam të thyhej një shkurre e thatë:

- Mirëserdhët ore, burra! A thua se u ka lodh rruga?! Unë jam Pal Nikoll Melyshi!

Duhet me mbarua punë shpejt, që ene ju por ene unë të mos vonohemi!

Fillova të ndjehem shumë keq, po dridhesha!

- Mos u ligështu, burri i dheut- tha Pali e kam llogarit se ku do ta marr plagën. Nxori nga pantallonat një këmbishë të pambuktë dhe ngriti fanellën prej leshi, lart mbi ijën e djathtë.

- Ja këtu, - tha dhe e tërhoqi fort, shumë fort lëkurën e hollë në ije.

E kisha mbledhur veten. I them shoqëruesit tim se nga goditja e afërt, Naganti nxjerr flakë dhe do të digjet lëkura, prandaj, duhet vënë përpara tytës një shami. R. K. nxori nga xhepi një shami të vogël.

- Ja ku e ke, gati.

- Pal Melyshi, o burrë i Mirditës! - a mos je tu më lënë në gjak me këtë plagë që jam dukë të dhënë!

- Qe besa e burrit, brez pas brezi nuk më ke hak e as hile!

- Çfarë do t'i lemë si kujtim, apo si dëshmi njëri tjetrit?

- Unë po të lë këtë. Qe, një shkop fra-shri i drejtë dhe i hequr lëvozhga në formë spiraleje.

- Do të kisha dëshirë të ma ruanit shaminë e shpuar dhe të djegur se, kur të takohemi, do ta mbaj si kujtim.

R. K. ia tërhoqi fort lëkurën në ije. Unë e palosa shaminë më katërsh, e afrova njëzet centimetër afër dhe tërhoqa këmbëzën.

- Na qoftë për hair, burra! Mirë u takofshim në Tiranë! U përqaftuam fort të tre, zbrazëm breshëritë e automatikëve duke simuluar një përpjekje më armë dhe mirditasi, Pal Melyshi, me plagën që i kullonte gjak, u zhduk nga sytë tanë.

Më duket së sonte po i rri pranë Pal Melyshit! ...

Kishte filluar dita e re. Punonjësit e turnit të parë kishin ardhur dhe, pa i vënë re, na kishin rrethuar e po dëgjonin, ndoshta historinë më të çuditshme të thënë ndonjëherë në atë spital nga Drejtori i tyre!

AUSTRO-HUNGARIA DHE "MOSMIRNJOHJA" SHQIPTARE!

100 VJET NGA VITI 1913 ...

Vetëm fakte e data: (Do t' i referohem pjesërisht studiuesit Gjush Sheldija).

Në vitin 1856 vijnë në Shkodër pesë austriakë, për me bisedue me sundimtarin turk dhe ikin pa u marrë vesh prej askujt bisedimet. Edhe nga Stambolli po atë vit, vjen një i derguem me bisedue me konsullin austriak në Shkodër. Ai u takue me Ipeshkvin e Shkodres dhe Pashën. Në vitin 1858 hidhet Guri i Parë i Kishës Katedrale të Shkodres. Kushë Micja lejohet me hapë shkollë për vajza. Asht viti 1859, kur themelohet Seminari Papnor i Shkodres. Në Gusht të vitit 1861, Françeskanët ndërtojnë Kuvendin e tyne në Shkodër. Lejohen me u botue librat e Don Ejëll Radojës, të gjithë me karakter nacional e historik, në gjuhen shqipe. Në shkurt 1867, Shkodra bahet Seli Argjipeshkvnore.

Me 1 Shtator 1871 zhvillohet Konçili i II Shqiptar. Në Tetor 1874, hapet shkolla e parë laike në Shirokë, ku mësohet gjuha shqipe dhe aritmetikë. Në shkurt 1878, Malet e Veriut protestojnë kundër qeverisë Athinës, për çështjen e Epirit. Në 1899, Abati i Mirditës Imz. Preng Doçi krijon në Shkodër Shoqinë Letrare "Bashkimi". Në vitin 1902 Shkolla Françeskane jep mësimet në gjuhen shqipe. Në vitin 1903 Shoqia "Agimi" në Shkodër, fillon botimin e librave me Alfabetin e vet. Në vitin 1908, Shkodra dërgon në Kongresin e Manastirit At Gjergj Fishtë, Don Ndre Mjedjen, Luigj Gurakuqin, Mati Logorecin dhe Hilë Mosin, ku aprovojnë Alfabetin e Gjuhës Shqipe të krijuem nga At Fishta. Po në Shkodër, formohet klubi "Gjuha Shqipe". Në vitin 1909 në Shkodër dalin gazetata "Koha" dhe "Bashkimi", me karakter letrar e Atdhetar. Në korrik 1910, vjen në Shkodër Xhavit Pasha me 20 batalione me shtruve Shkodren. Bahet luftë në Kaçanik, dhe çohet në kryengritje gjithë Malësia e Madhe. Në 1911 plasë Kryengritja e Kastriotit dhe me 6 Prill 1911, në Maje të Bratilës së Deçitit, Atdhetari Dedë Gjo' Luli, ngriti Flamurin Nacional të Gjergj Kastriotit. Malësia e Madhe lufton për Liri dhe Pavarësi Nationale. Në Maji 1911, Kryengritja kundër Turqisë përfshinë Malet e Veriut. Në çelen e Gerçës, me 10 Qershor 1911, Malësorët e Veriut nënshkruajnë Memorandumin e Gerçës, të cilin, ua dërgojnë Fuqive të Mëdha dhe Turqisë. Aty shënohet: "Malësorët janë të vendosun për mos me ulë armët derisa, të pranohen nga qeveria turke të 12 pikat e këtij Memorandumi..." Në Tetor 1912, plasë Lufta Ballkanike dhe po në fillim të muejt Tetor rrethohet Shkodra nga malazetë ... Ashtu si tjera herë Miss Mary Edith Durham, me përkushtimin e Saj ndaj Shqipnisë, do t'i bajë të kjartë qarqeve angleze dhe atyne ndërkom-bëtare se: "... ekzistonte në qarqet katolike austriake vendosmëni për mos me lejuje që Shkodra dhe hinterlandi i saj, të

bahen respektivisht një qytet apo rajon malazet ose serb." (P.R.O.F.O. 371. 1758, fq. 447. Mr. Nevinson, Podgorica. 26. 02. 1913. M. E. Durham). Shkodra vazhdon me kenë e rrethuese ...

Me 28 Nandor 1912, në Vlonë shpallet Pavarësia Nationale. Nga Shkodra atje



Shpata e prekenarja e Gjergj Kastriotit, në muzeumin në Tiranë

shkon Luigj Gurakuqi. E po mos t' ishte kamngulja e Tij, pjesëmarrësit tjerë e lanë Shqipninë në duertë e qeverisë turke, e cila kërkonte me "krijue një Shqipni të vetqeverisun, në suazën e Perandorisë Otomane".

Me datën 30 Janar 1913, Esad Pashë Toptani vret Hasan Riza Pashen, i cili donte me ngritë Flamurin Nacional në kumbonare të Kishës Katedrale të Shkodres, dhe me 23 Prill 1913, Esad Pasha ia shtet Shkodren malazetëve për 2 milion florinjta, dhe ata hyjnë në Shkodër nga Taraboshi, Fusha e Shtojit dhe Bardhanjorët. Me 14 Prill malazetët djegin Pazarin e Vjetër dhe mbasi grabisin mallin ia dozojnë Shkodren Ushtrive Ndërnacionale, austriake, italiane, franceze, angleze dhe gjermane. Me datën 13 Qershor ngritët Flamuri Nacional në Kështjellën Rozafat, dhe fjalën e rastit e mbajti Atdhetari Karlo Suma. At Gjergj Fishta vendosë një Flamur në kumbonaren e Fretenëve të Gjuhadolit, dhe rinia shkodrane këndon Himnin e Flamurit të krijuem nga At Gjergj Fishta nder rrugët e Shkodres...Qyteti i Lirë, nën kontrollin e forcave ndërnacionale Feston Lirinë!

Esad Pashë Toptani ikë në Durrës dhe shpallet sundues. Princ Wiedi len Shqipninë me 5 Shtator 1914. Në 1915 edhe Esad Pasha ikë nga Durrësi, prej protestave kundër tij.

Me 23 Janar 1916 ushtria austro-hungareze pushton Shqipninë e Veriut, Serbinë, Malin e Zi e dalin në Durrës. Në 1916 forcat austriake hyjnë në Shkodër. Në 1917, formohet në Shkodër "Komisija Letrare". Me 30 Tetor 1918 ushtritë austro-hungareze dalin nga Shkodra dhe hyjnë Aleatët. Në Mars 1920 formohet i pari Parlament Shqiptar...

Nga viti 1856 e deri në vitin 1918, Austro-Hungaria asht i vetmi shtet Evropian që ka krijuje të gjitha kushtet për Formimin dhe Shpalljen e Pavarësisë Nationale të Shtetit Shqiptar.

Po mos t' ishte kambëngulja e Vjenës Evropiane me formue inteligjencën Atdhetare Shqiptare dhe Klerin Katolik Shqiptar të papërsëritshëm me idealin "Atdhe e Fe", me hapë shkolla, fletore, shoqata, shtypshkronja, me botue libra, me shpenzue edhe fonde monetare të sajat ... sot as në hartë të Ballkanit nuk do t' ishte fare emni i Shqipnisë së Gjergj Kastriotit, as i Popullit Heroik Shqiptar dhe as Flamuri i Tij me Shqipen dykrenare, mbi shtrojën e përgjakun nder Shekuj!

At Pjeter Mëshkalla ka thanë: "Kleri Katolik Shqiptar asht kleri ma heroik që ka me cilësue historia në rrugën dymijëvjeçare të Krishtit, sepse, mbas pesëqind vjet robnije nën Turqi, po të merret historikisht prej vitit 1912, kur Shqipnia u formue si shtet e deri me 1944, që këtu erdhën në fuqi komunistët, tue lanë në njëanë okupacionin fashist italian (me të cilin nuk jam pajtue kurrsesi), janë vetëm 30 vjet mundësi për me formue një Kler Shqiptar, e për 30 vjet me nxjerrë aq Heroj sa kemi nxjerrë na, nuk ka asnjë kler në Botë." (F. R. tek libri "At P. Mëshkalla S. J.", fq 23, 1993)

Dhe vetëm faktet do të flasin ...

Vetëm nga Klerikët Shqiptar të pergatitun në **Austri**, shikoni se çfarë **Gjenocidi** ka ngja mbas vitit 1944, nga tradhtarët dhe diktatorët anadollakë Enver Hoxha dhe Ramiz Alia ... të cilët, kanë ardhë në kolltukët e qeverisjes së shtetit shqiptar me ndihmën e fqinjëve, shitën trojet tona, dhe në mënyrën ma barbare zbatuen diktaturën ma të mnëshme të shekullit XX mbi Popullin Shqiptar.

Sot pasuesit e tyne hajdutë, deklarohen "vëllezër gjaku me turqit" dhe serbët e kolltukut!

Klerikë Katolik Shqiptarë të zhdukun nga Gjenocidi komunist mbas vitit 1944:

Don Lazer Shantoja, pushkatue me 5 Mars 1945.

Don Ndre Zadeja, pushkatue me 25 Mars 1945.

At Anton Harapi O.F.M., pushkatue.

At Mati Prennushi O.F.M., pushkatue.

At Çiprian Nikaj O.F.M., pushkatue.

At Bernardin Llupi O.F.M., pushkatue.

Don Dedë Plani, vdekë në tortura.

Imzot Nikollë Deda, pushkatue.

Don Aleksander Sirdani, mbytyë në hetuesi.

Imzot Jul Bonatti, mbytyë në çmendi...

Don Shtjefen Kurti, pushkatue.

At Leonard Targaj O.F.M., pushkatue.

Don Nikollë Gazulli, vra tradhtisht.

Imzot Vinçenc Prennushi O.F.M., vdekë në burgun e Durrësit.

Don Anton Zogaj, pushkatue.

At Bernardin Palaj O.F.M., mbytyë në hetuesi.

Don Nikollë Laskaj...vdekë në kampin e shfarosjes Beden...

Don Nikollë Shelqeti...vdekë në kampin e shfarosjes Beden...

At Klement Miraj O.F.M., vdekë në burgun Burrel.

Don Rrok Frisku, vdekë në burgun Burrel.

At Rrok Gurashi O.F.M., vdekë në kamp shfarosje.

At Gasper Suma O.F.M., vdekë në burg...

Don Kolec Prennushi, vdekë mbas hetuesisë.

Imzot Frano Gjuraj, vdekë mbas hetuesisë.

Klerikë të burgosun që vyejten shumë vite nder burgje e kampe shfarosje...

At Pjeter Meshkalla S.J. burgosë dy herë.

At Leonard Shajaku O.F.M., burgosë e internue.

At Marjan Prela O.F.M., burgosë e internue.

Don Nikollë Dragusha, burgosë.

Don Lekë Dredhaj, burgosë.

At Mark Harapi S.J. burgosë.

At Frano Kiri O.F.M., burgosë e internue.

At Marin Sirdani O.F.M., burgosë e internue.

At Alfons Çuni O.F.M., burgosë.

Don Ndre Lufi, burgosë.

Don Ndue Suma, burgosë.

Don Jakë Zekaj, burgosë.

Imz. Bernardin Shllaku O.F.M., burgosë.

Klerikë që vdiqën shpejtë pa u përfshi nga Gjenocidi...

Imz. Gasper Thaçi, vdes në 1946, i izoluem në Argjipeshkvi të Shkodres.

Imzot Gasper Guirakuqi.

At Simon Mikeli O.F.M., vdes në 1945...

At Anton Kiri O.F.M., vdes në 1945

At David Pepa O.F.M..

Don Ast Koka.

Don Nikollë Dajçi.

Don Mati Fishta.

Don Nikollë Lazri.

Don Pashko Zojzi.

At Justin Rrota O.F.M..

At Pashko Prela O.F.M..

Shënim i Autorit:

Në listat emnore të Klerikëve katolik, nuk përfshihen asnjë nga ata që u përgatiten në

universitetet tjera Evropiane, përveç Austrisë, para vitit 1944.

Nga Fritz Rodovani, Marre nga gazeta "Tribuna Shqiptare", date 14 maj 2013

KATRINA E VJEHRRI I SAJ

Anton Leke Gjocaj nga fshati Ziçi i Mirditës, emigrant në Itali, para 2-3 vjetësh u martua me një vajze dukagjinase nga fshati Kir, me emrin Katrine, bije e shtëpisë së përmendur të Martin Prekes.

Po i u realizua kjo martesë?

Një histori krejt e veçante, e gëzuar, e dhimbshme dhe më në fund tragjike!

Katrinën, në moshën 16 vjeçare kreu një krim të rende. Vrau një djalë të ri, të pafajshëm nga fshati i saj. Po, pse e vrau bashkëfshatarin e saj, tashme banorë të lagjes "Mark Lula", në qytetin Shkodër?!

Axha i djalit, për shkaqe banale, vrau axhën e Katrines duke lenë gruan e femijet e tij jetime, në kushte të vështira jetese. Me vone, ky njeri që nuk u ndëshkua nga ligji e për pasojë ai bën edhe një krim tjetër duke vrare babën e Katrines nga frika e hakmarrjes për vrasjen Zefit, la gruan me pese jetime, në kushte të vështira e në mjerim të madh. Femijet rriteshin, por urrejtja për njeriun që i la pa baba shtohet, aq më tepër që autori nuk po ndëshkohej. Dhe, më në fund erdhi dita që krimet e axhës t'i paguaj nipi i tij, në moshe fare te re. Vrasjen e mori përsipër njëra nga vajzat, pikërisht Katrina, për të cilën ajo u dënua me 13 vjet heqje lirie.

Në burgun e grave në Tirane, Katrina u bë e njohur shpejt ma gra e vajza të dënuara për krime të ndryshme. Midis të tjerave, ajo gjeti një vajze mirditore, me të cilën ndërtoi një shoqëri të ngushtë, u bene shoqe dhe si bashkëvuajtëse gjeten gjuhen e përbashkët. Çdo dite e më shumë ato e shtonin shoqërinë dhe miqësinë midis tyre. Mirditores po i pëlqenin tiparet dhe cilësitë e Karinës, çdo dite e më shumë. Ajo u prek shumë kur mori vesh se i fejuari pas dënimit e kishte ndare Katrinën. I jepnin kuraja njëra-tjetrës për t'u përshtatur jetës së re, në kushtet e izolimit.

Mirditorja aq shumë iu përshtat vajzës dukagjinase, sa më në fund u bë shkak për një lidhje të re të Katrinës, pikërisht me vëllanë e saj emigrant në Itali, të cilin e ftoi për të njohur shoqen e saj, për të cilën jepte garanci se, nuk do të zhgënjehet.

Vëllai nuk vonoi, erdhi, takoi motrën, mori të dhënat e nevojshme, pa dhe Katrinën e pasi u bind i dha fjalën asaj. Po, afrohej lirimi i saj dhe për rrjedhojë duheshin marre masat te tjera në funksion të kësaj lidhje të re. Puna e Antonit, i cili erdhi disa here nga Italia, u shtri tek prindërit e tyre, së pari te Tringa, nena e Katrinës, e cila ua dha bekimin pas kësaj dhe me prindërit e t'afërmit e tij në Ziç.

Me pëlqimin e të dy palëve, sapo Katrina mbaroi dënimin u deklarua fejesa, u bë shpejt dasma nga më madhështoret. Gëzimi dhe hareja e çiftit u bene objekt i këngës, i valles, i qindra urimeve nga të dy krahët dukagjinase e mirditore. Pas disa

ditësh, çifti i ri u përcoll për në Itali, atje ku Antoni kishte punën e jetën e tij, nga një numër i madh njerëzish, të afërmit, shoke, miq, e me lot dhe prindërit.

Antoni dhe Katrina, me gëzim e me harmoni po kalonin dite të lumtura, aq më tepër kur ata morën vesh se, do bëheshin prindër, me krijesën e tyre engjëllore që dita-ditës rritej në barkun e nënës.

Ecuria e shtatëzanisë së Katrinës u bë objekt i mjekësisë italiane, duke se do të kishte probleme të komplikuar rende. Erdhi momenti i ndërhyrjes kirurgjikale, nga e cila doli në jete djali, por Katrina, nena e tij e mbylli jetën e saj. Ajo nuk arriti ta shohë, ta gëzojë e ta përqafojë krijesën e saj.

Po, si u përballua kjo ngjarje tragjike për jetën e Katrinës?

Tringa, nena e saj, lajmin e kobshëm e priti me dhimbje e lot, sido nena kur humbe femijën e vet. Por, dhimbja për Katrinën që e veçante, sepse e rriti me vuajtje, të cilat nuk iu ndanë për 13 vjet. Megjithatë ajo qëndroi e forte!

Rrufeja ra në shtëpinë e Lek Gjocajt. Antoni u përpoq ta mbante veten, ta përballonte humbjen e shoqes së vet, e cila i la djalin e vogël si kujtim të jetës së shkurtër, por të lumtur që kaluan së bashku.

Nëse Antoni e përballoi fatkeqësinë, baba i tij, Leka, nuk mundi, dhimbja për të rene e tij, të cilën e deshi aq shume e çoi në aktin e vetëvrasjes. Një tragjedi e vërtetë në këtë truall.

Me 26 gusht të vitit kaluar, qindra njërës u tmerruan e me lot në sy morën pjesë në këtë ceremoni mortore të pa shoqe, në përcjelljen e tyre për në banesën e fundit, të Lekes e të Katrinës. Vendasit në këmbë për tu pritur e nderuar burrat e gratë e Kirit dhe shume dukagjinase të tjerë.

Lot e dhimbje të madhe shprehen njerëzit që shkuan në këtë ceremoni mortore nga Shkodra, nena, motra, vëllai, t'afërmit, miq e shoke të babës e familjes, dhjetëra e dhjetëra prej tyre i dhanë lamtumirën e fundit bijës së tyre atje në fshatin Ziç të Mirditës.

Fjalët e mira që u thane atje për bijën tone ishin një ngushëllim për Tringen e njerëzit e saj, ishte një krenari për ne, për të gjithë pjesëmarrësit.

Leke Gjocaj ishte burrë i sojshëm, bijën tone, nusen e djalit e deshi shume, sepse ajo meritonte dashuri e respekt dhe ajo nuk kursej kurrë për vjehrrin e njerëzit e burrit. Ai për një moment mori një vendim tragjik, të vetëflijohet, dhimbja e mposhti, "... çka më duhet jeta pa nusen, si do rritet nipi i im ...", ishin fjalët e fundit të Lekes! Prandaj vendosi ta shoqëronte t'rene e tij për në banesën e fundit. Ai, nuk donte ta linte vetëm nusen e tij.

Nga Ndoc Grimaj

Revistës "Endërra Shqiptare" i jepet titulli "Mirënjoha" dhenë nga N/Prefketa i Malësisë së Madhe, Sytki Ndreca

RUSH DRAGU, THEMELUESI DHE DREJTUESI I REVISTES "ENDËRRA SHQIPTARE", QE BOTOHET NE MIÇIGAN TE SHBA, MERR TITULLIN "MIRËNJOHJA", E DHENË NGA N/PREFEKTI I MALËSISË SË MADHE, TË DHËNË ME RASTIN E 100 VJETORIT TË SHPALLJES SË PAVARSISË SË SHQIPERISE

Vizita e ketyre ditëve të zotit Rush Dragu në Shqipëri ka bërë të mundur që ti dorzohet titulli "Mirënjoha", e dhenë me rastin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, per portalin online **Albdreams** (Ëndërrat Shqiptare), pronar, themelues dhe drejtues i të cilit

elektronike nga Institucioni i Nënprefektit M. Madhe.

Të pranishëm në dorzimin e titullit "Mirënjoha", Rush Dragut, ishin edhe gazetar, publicist e miq të Albdreams-it si dhe biznesmeni i njohur, mbeshtetes e kontribues per vlerat nacionale shqipt-



Rush Dragu duke marrë titullin "Mirënjoha" nga Nënprefekti i Malësisë së Madhe, Sytki Ndreca

është, i nderuari Dragu që prej dates 26 nentor 2004, kur kjo dritare e madhe, drite u hapë në qiellin e medieve elektronike Amerikane. Per kontributin e madh në promovimin e vlerave kulturore, artistike, publicistike e historike ketij portali shqiptarë me daten 28 nentor 2012. Nënprefekti i Malësisë së Madhe, Sytki Ndrecaj i jep titullin "Mirënjoha", e cila "fizikisht" nuk kishte qënë e mundur t'i dorzohet me pare, pasi ishte ne SHBA. Kjo mundesi u krijua me daten 14 maj 2013. Dorzimi i ketij titulli në ketë ditë u bë nga Nënprefekti, Sytki Ndrecaj, me pranin e Nënprefektit të sotem të Malësisë së Madhe zotit Islam Semanaj, gjë që tregon vijimsin e vlersimit të kesaj medie

tare, Ndue Ftoni,

Gjatë dorzimit të ketij titulli, të pranishmit vlersuan portalin Albdreams si një dritare plot dritë ku secili ka çfarë të shoh, dhe ka çfarë të thotë, pa asnjë censure apo privim, me një liri, të cilën sot është veshtirë ta geshë në mediat e tjera shqiptar. Albdreams-i u tha nga të pranishmit është edhe një urë lidhese elektronike, në mes shqiptareve që banojnë në Amerikë e vende të tjera dhe atyre të Shqipërisë politike dhe etnike. Albdreams-i është edhe një zë i fuqishem shqiptarë në tempullin e lirisë e demokracisë (SHBA), dhe per këtë merita kryesore i takon Rush Dragut.

Nga Ndue Bacaj

Kolegji saverian



Nga: Smajl Bala

Shkollave katolike në Shkodër, më 17 tetor 1877 i shtohet edhe kolegja saveriane, me themelues At Luigj Mazza, i cili, edhe pse mësues i ri, i dhuroi prej pasurisë së tij kësaj shkolle 1100 napolona ar. Hapja e kësaj shkolle u arrit edhe në sajë të 22 qytetarëve shkodranë nga paria e besimit katolik, të cilët në një takim që patën me drejtorin e financës të vilajetit të Shkodrës, i parashtruan nevojën e hapjes së një shkolle të mesme, duke e pajisur atë me mjetet e nevojshme për një funksionim normal. Kontributit të jashtëzakonshëm financiar të At Luigj Mazzës iu shtua edhe ai i besimtarëve katolikë, të cilët arritën të mbledhin edhe 500 napolona ari, të cilat do të shërbenin për ndërtimin e shkollës.

Më 17 tetor 1877, në kishën e vogël të jezuitëve, u mblodhën qytetarët shkodranë, familjet e 30 fëmijëve (nxënësve të parë) të kësaj shkolle dhe para tyre At Zef Lombardini i paraqiti popullit institutin e ri që mori emrin e "Sh'Françesk Saverit", duke u shprehur, ndër të tjera, se "...do të delte për dobi e nder të qytetit".

Stema e kolegjit është e përbërë nga shqipja kombëtare, në anë të së cilës shkruhet: "Për Zot, për Atme e Përparim". Redaktor në këtë kolegji emërohet P.Ambroz Marlaskaj. Në vitin 1878-81, zv/redaktor ka qenë At Luigj Mazza, madje për drejtimin e kolegjit u pat ngritë edhe një komision me persona të njohur katolikë të qytetit: Sima i Zef Simonit, Cin Suma, Gjek Muzhani, Simon Shiroka, Ndre G.Llupi (Melgushi), Ndre Shiroka, Pashko Serreqi.

Në vitin 1888, Austro-Hungaria e subvencionoi me 4000 fr.ari në vit, shumë të cilën më vonë erdhi duke e rritur. Me shkatërrimin e Perandorisë Austriake në vitin 1919, shkolla më pas mori subvencione nga Italia. Mësimet në shkollë jepeshin falas, por vetëm në fillim nxënësit ishin të detyruar të paguan taksën e shkollës.

Ndërtesa e kolegjit ka qenë ndër më të bukurat e qytetit të Shkodrës, madje në vitin 1890 ajo kishte sallën e teatrit me një kapacitet prej 450 vendesh.

Kolegji saverian, përmes programit mësimor, arrinte t'u jepte fëmijëve dije shkencore e kulturë të gjithanshme bashkëkohore. Deri në vitin 1913 lëndët ishin: shqipja, latinishtja, italishtja, frëngjishtja, matematika, fizika, historia, gjeografia merceologjia, statistika, vizatimi. Prej vitit 1914 kolegji qe me gjashtë klasa, tri teknike e tri tregtare, në vitet 1914-1916 me katër klasë reale (praktike) e dy tregtare me programe të përpunueshme, në vitet 1919-1925 ka gjashtë klasa tregtare e normale, me mësimet të karakterit pedagogjik. Në vitin 1926, kolegji ndrron kah, nisi gradualisht të lërë drejtimin tregtar e të kalojë në gjimnazin klasik.

Në shkollën jezuite, shqipja mësohej si lëndë më vehte, krahas mësimet të tjera që jepeshin në italisht. Deri në Kongresin e Manastirit të vitit 1908, në këtë shkollë shqipja shkruhej me alfabetin e vjetër të Veriut, ose me atë tradicional, më pas sipas alfabetit të shoqërive "Bashkimi" e "Agimi".

Shkolla, në vitin 1888 pësoi ndryshime në përbajtje dhe në organizim, me qëllimin që shpejt të kalohej në krijimin e një gjimnazi klasik. Kështu që nga ky vit, kolegji mund të quhet "Gjimnaz klasik". Nga fillimi, deri në vitin 1916, shkolla kishte katër klasë reale dhe dy klasë tregtare, me programet e mëparshme. Nga viti 1919 deri në vitin 1925 përbëhej prej katër ose gjashtë klasash tregtare e normale, me të mesmen pedagogjike. Në fund, në vitin 1926, kolegji kaloi në një gjimnaz modern.

Ndërtesa e parë shkollore ka qenë shtëpia e zotërinjve Llupi-Mëlgushi në zemër të qytetit, në një vend të qetë ku mësimi zhvillohej normalisht, larg zhurmave të rrugës. Për t'iu përshtatur sa më mirë kërkesave të shkollës, u bënë adaptimet përkatëse, në mënyrë që vijueshmëria mësimore të mos haste asnjë pengesë, por dhe të ishin kushtet optimale edhe për stafin pedagogjik, që të bënin punë shkencore e akademike, por edhe nxënësit veprimtari të ndryshme artistike. Edhe pse pat pengesa nga qeveria turke, Austria i qëndroi gati dhe u bë mbështetje për shpenzimet eventuale. Saloni i zburkua hijshëm nga piktori i kishës, mjeshtri Pr.Moschini.

Një kat i ri iu shtua ndërtesës në vitin 1906. Në këtë vit ndërtesa meremetohet pasi pësoi dëmtime nga tërmeti shkatërrues i vitit 1905. Në vitin 1914, në vendin ku familja Guga kishte pasë oborrin, u ngrit një ndërtesë dykatëshe, ndërmjet shtypshkronjës e salonit, që u pat lënë për shkollë fillore.

Në relacionin e konsullit të Austrisë në Shkodër, shkruhet: "Seminari, i cili po ndërtohet me lejen e qartë të guvernatorit, ishte vetëm një shkollë krishtere dhe aspak kishë, siç deklaroi komisioni turk. Ndërtesa nuk është zgjëruar aspak në mënyrë të papërshtatshme, por aq

sa kjo ishte patjetër e domosdoshme, me qëllim që të zahnë 40 nxanës bashkë me personalin mësues. Në fund të ndërtesës ajo po ngrihet me shpenzimet e Aus-



trisë. Prandaj ajo duhet respektuar si prej mexhlisit, ashtu edhe prej popullit dhe mund t'i nënshtrohet vetëm gjykimit ma të naltë në Stamboll". (Bëhet fjalë për rrëzimin e pjesës së shtuar – shënimi im, S.B.) Në relacionin tjetër shkruhet: "Në qershor 1856 ndodhi një katastrofë e vajtueshme. Kjo ishte prishja e seminarit të ri, në kundërshtim me edukimin e priftërinjve nacionalë...dhe për ndërtimin e tij është dhuruar një shumë prej 800 fr.ari. Institucionet morën përsipër 3000 fr.ari në vit për mbajtjen e tij. Tentativat kishin filluar që në vitin 1843. Më poshtë, relacioni vazhdon: "Në vend që të ngulet këmbë me e mbajtë seminarin e vjetër që ekzistonte atëherë, ku përgatiteshin 11 nxënës për detyrën e priftit e me i ba heshtazi atij disa riparime e adaptime të përshtatshme dhe me e ngritë përparimin, nivelin e mësimet dhe të edukatës që kishte rënë poshtë për faj të drejtorit të mëparshëm, peshkopit të soçëm, Dod Mazzit dhe pasardhësve të tij dhe për të sjellë mësues ma të disiplinuem dhe duke vu në konditë të domosdoshme me e braktisë institucionin e vjetër, i cili deri tash nuk ishte kërcënue nga asnjë anë, sepse gjindej afër një xhamie dhe propozi blerjen e një shtëpie prej 10.000 fr.ari dhe adaptimin e saj për një seminar, projekt të cilin e kundërshtoi peshkopi Tapic. Veç kësaj, mjetet e ndërtimit që dha Austria dhe Propoganda në Romë ishte vetëm 12.000 fr. Prandaj u ble shtëpia tjetër (e Çobajve) për 6000 fr., por ato nuk mjaftonin për me e transformue atë shtëpi. Kështu që sa të fillojnë ndërtimi, u kërkua dërgimi i kistit të parë për seminarin, i subvencionuar 3000 fr. në vjetë.

Në kolegjin saverian gjuha shqipe u dha si lëndë e posaçme. Lëndët që zhvilloheshin këtu ishin: gjuha shqipe, italishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, turqishtja, matematika, fizika, shkencë natyre, shkencë tregtare, statistika, historia, gjeografia, vizatimi, filozofia morale, religjencë apologjitime, tagre natyre, civile, tregtare, edukatë fizike si dhe gjuhë e lirë, latinishtja. Shkolla ishte me gjashtë klasa, tri teknike e tri tregtare të nalta.

Një ndër qëllimet kryesore të kolegjit, por jo i vetmi, ishte edukimi fetar

i nxënësve, qëllimi më i shenjtë dhe më i parë i veprimeve të kolegjit e njëherit edhe mjet i fuqishëm për edukimin civil e trajtimin shpirtëror të tyre. Për realizimin e qëllimeve mësimore-edukative përdroreshin forma të ndryshme pune përmes një pune gjithëvjetore të stafit pedagogjik dhe të një baze materiale-didaktike të lakmueshme për kohën. Praktikohej ndarja e nxënësve në grupe, bëheshin provime të hapura, zhvilloheshin konkurse. Fituesit nderoheshin me çmime.

Mësimet në kolegji zhvilloheshin para dhe pasdreke. Në përbërjen e tij ai mbledhte djelmëninë e të tre religjioneve në Shkodër: katolik, ortodoks dhe mysliman. Po ashtu edhe mësuesit (profesorët) u përkisnin tre besimeve fetare dhe shumë prej tyre ishin figura të njohur në fushë të mësuesisë. Mësimet këtu ishin pothuaj të njëjlojta me seminarin. Redaktorët lëviznin sa nga një shkollë në tjetrën. Shkolla drejtohej nga Urdhëri i Jezuitëve.

Në këtë shkollë, me deklaram të Mbretit, emërohet mësues Cin Cepuli. Emërimi i tij nga ana e mbretit u bë pasi Cini kishte fituar konkursin për këtë vendpune.

Në vite në këtë shkollë qe një numër i madh i mësuesve, si: At Luigj Mazza (themeluesi i saj), Filip Ashiku, Gaspër Benussi, Musa Efendi Boriçi, Fejzullah Efendia, Fejzi Efendia, Pashko Gurakuqi, Mati Logoreci, Mark Harapi, Pjetër Gjura, Pjetër Marubi, Gaspër Mikeli, Jak Junga, Gjush Sheldija, Ndoc Vasija, Gjon Bazhdari, Luigj Naraçi, Kolë Thaçi, Gjon Shiroka. Në bankat e kësaj shkolle janë ulur shumë prej atyre që u bënë personalitete të shquara në shumë fusha të jetës, midis të cilëve edhe Faik Konica, Luigj Gurakuqi, Donat Kurti, Mati Logoreci, Gaspër Mikeli, Zef Harapi, Ethem Osmani, Karl Gurakuqi, Selaudin Bekteshi, Gjush Sheldia, Ndoc Rankolli, Vasil Stafa, Qemal Stafa, Filip Shiroka, Teufik Bekteshi, Kolë Mirdita etj.

Shkolla kishte dy kabinete, një fizike e një kimie. Këtu u themelua shoqata "Leka". Në këtë shkollë u botuan 412 libra shkollorë, midis të cilëve po përmendim: 16 gramatika, 1 fjalor, 19 libra shkencorë, 5 libra letërsie, 6 libra histori-gjeografie, 34 libra këndimi e edukimi.

Kolegji i jezuitëve u bë i njohur edhe për muzeum ndër më të zëshmit për kohën, një sallë teatri, ku jepeshin shfaqje dhe viheshin në skenë drama e tragjedi. Kaq i organizuar qe, sa kolegji pat edhe hymnin e tij, të shkruar nga Dom Lazër Shantoja. Ndërkohë MA kërkoi nga kjo shkollë të dijë se sa orë mësimi në javë dhe cilat lëndë jepen e në cilat klasa.

Në një takim që ka organizuar në këtë kolegji, prefekti i Shkodrës i asaj kohe, Xhafer Ypi, në fjalën e mbajtur është shprehur: "Prandaj gëzohem m'u gjet sot në kte vend, si po bje me konstatue e botnisht po më kande me dëshmue, epet nji edukatë letrarishte, shkencore e morale vërtetë e mirë tejet. i kjoftë lavdi eproëve e profesorëve të ksaj kolegje. Këtu jepet trajtimi i shëndoshë i asaj djemnie që ka me kenë kurrizi i Shqypnis s'onë të njoftme si Kom e Shtet i pavarshëm".

(vijon në numrin e ardhshëm)

Vëllimi poetik "Mjegull" i poetit Lazer Kodra.

Me 15 të Muajit Qershor, poeti Lazer Kodra doli para lexuesve të tij me vëllimin poetik "Mjegull", promovimin e të cilit e bëri në mjediset e Bibliotekës "Marin Barleti" në prezencë të një auditori shumë cilësor, në veçanti në fushën e letrave. Kjo veprimtari u zhvillua edhe në kuadër të 10-vjetorit të krijimit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", në të cilën autori i librit ka qenë dhe është ndër më aktivët e saj, sidomos si kryeredaktor i gazetës "Dukagjini".

Ky libër është i teti në krijimtarinë e Lazer Kodrës dhe i katërti vëllim me poezi në një periudhë 9-vjeçare që i bie afërsisht nga një në vit, prodhimtari për tu pasur zili nga krijuesit më në zë. Gjithnjë promovimet e librave të Kodrës kanë qenë cilësore edhe në sajë të bashkëpunimit me të papërtueshmin Aleks Dushi si organizator i tyre. I tillë ishte edhe i fundit në radhë. Gjithçka shoqërohet në një monitor me mjedis të mrekullueshme ku autori ka marrë frymëzim, ku lumi rrjedh rrëmbyeshëm në shtratin e të cilit bashkohen aroma e luleve, fladi i pemëve, oshtima e ortekëve të borës, blegërima e deleve dhe ulërima e ujkut, kënga e shtojzovallëve, thirrja e legjendave e kuvendi i burrave, uji i krojeve e hijeshia e grave të mrekullueshme. Të gjitha mblidhen si pikat e ujit e duke u ndeshë faqeve të shkëmbinjve, formojnë forma të përkryera, të kthyer në figura letrare që vijnë si një këngë e bukur dhe mbërrijnë tek ne, në faqet e librit "Mjegull" të poetit Lazer Kodra. I shoqëruar nga një mjedis me mjegull në monitor, aktori Tomi Delija reciton vargjet e poezisë që ka marrë emrin libri.

Sapo hap librin, ai të ngjall interes që në parathënien prej profesionistësh të poetëve Ledia Dushi e Prelë Milani të cilëve nganjëherë do ju referohemi. Në poezinë "Mjegull", Ai e dinte nga i ati se këtu është vendi i mjegullave dhe në këtë udhë të vështirë, Atij i duhet të vrapojë "çirret", të thërras në një botë po aq të mjegullt dhe "copën" e diellit e rrok fort në gji si shpresën e vetme që një ditë me rrezet e tij të shpërndajë mjegullat e stërgjata në vendin e tij. Pra, poezitë e tij janë në gjendje mbijetese, por janë edhe besim në të ardhmen. Përdor mjeshtërisht metaforën, alegorinë dhe të gjitha format e tjera poetike. Ja si shprehet poetja Ledia Dushi: "Lazer Kodra ka krijuar një mëvetësi në stilin e të shkruarit, me motivet që rrok poezia e tij, në kursimin e fjalës të cilës i jep gjithë peshën e duhur. Në shfaqjen e një bote e cila thajse nuk i ngjason kësaj reales që e përjetojmë me dhimbje çdo ditë, me aftësinë për të shikuar në zonat e thella të reales dhe shkal-

lën e thellë reflektive. Ai qëndron larg kënaqësive naive, lustrave për pushtet, motiveve erotike të rëndomta të cilat e kanë virusuar deri në palcë poezinë tonë e cila po varfërohet çdo ditë e më shumë. Autori gërmon, zbulon, percepton e konvertton atë në poezi. Ai është "inatçor" me turmat, me njerëzit pa qëllime, hipokritët, delitantët, lëpirësit



Vajza, Elsa duke i dhuruar lule babait

e atyre që "sundojnë kalanë". Ai krijon me poezitë e tij dimensionin që i duhet dhe i takon njeriut".

Rreth krijimtarisë së poetit Lazer Kodra, në mënyrë të veçantë për librin më të ri "Mjegull" dhanë opinionet e tyre disa nga pjesëmarrësit. I pari dha vlerësimin për librin në fjalë kryetari i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", i cili ndër të tjera u ndal: "Lazer Kodra në këto 10 vite ka qenë si një uragan i pandalur në punën e tij krijuese. Ai jo vetëm që ka formuar plotësisht veten si krijues i Dukagjinit dhe i Shkodrës, por edhe na ka krijuar një klimë të re të shikimit të zonës ku ka lindur e banorëve të saj. Të shikimit të problematikës së kohës që po kalojmë me gjithë vlerat e antivlerat e saj, të cilat e kanë frymëzuar e vijnë ta frymëzojnë. Ai i ka thurur vargje vendlindjes, punës, dashurisë duke paraqitë vetëm realitetin e duke dhënë mesazhe për të ardhmen". Një vlerësim të veçantë, poetit Lazer Kodra i bëri shkrimtari Skënder Temali duke e quajtur sa epik, aq lirik dhe vazhdon: "Vargu i tij herë gjëmon në epikë, herë

hap krahët në lirikë, sa në ndonjë rast më kujton poetin Martin Camaj. (Lazer Kodra e Martin Camaj janë dy degë të një trunqut ku patjetër që kanë edhe ndonjë gen të njëjtë- P. SH). Duke qenë poet qytetar Ai i përjeton me dhimbje jo vetëm plagët e së kaluarës por edhe të së sotmes. Vargu i fuqishëm i tij godet si vare mbi atdherrëmbyesit aq sa do ta klasifikojë poezinë "Rrëmbyesit" si poezi antologjike ku shkrimtari lexon vargjet e saj të fuqishme". Original në vlerësimin e tij ishte njeriu i letrave Prelë Milani, redaktor i librit e bashkautor i Lazrit në 3 vëllimet "Dukagjini ynë". Ai ndër të tjera tha: "Ky vëllim afirmon kredon artistike, domethënëse të autorit si poet i radhës në pjacën shekullore të letrave të Shkodrës. Është një vitrinë poetike që shpalo hapësira, fluturime lirike, dhimbje, ëndrra e shpresë, ku vargu vjen i latuar hollë, harmonik, si një serenatë ndjenjash të dëlira dhe marshesh fluturake rebelë. Ai shquhet si poet i kushtimeve, i protestës e shutimeve idhnake, kundër ligësive të shoqërisë së sotme. Lexuesi vërtetë ndjen një lloj trishtimi njerëzor, por autori na i ka lanë edhe disa shtigje të lira ku e qeshura, romancat lirike nuk e lejnë lexuesin të dëshpërohet, madje e nxjerrin nga pesimizmi".

"Ka një komunikim poetik që e demonstroi fuqishëm tek ky vëllim. Ai nuk ka nevojë të marrë ndonjë lloj mekimi nga vjershëtorët tonë të mëparshëm për tu pajisur me licencën e poetit, sepse Ai i kapërcyer ata në të gjitha rrafshet dhe dimensionet" – theksoi pedagogu i Universitetit "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës, Gjergj Perluca. Mbresëlënësisht ishin vlerësimet që dha Dedë Zhivani, një ndër drejtuesit e veprimtarët më aktivë të Shoqatës "Nikaj-Mërturi", i cili vlerësoi jo vetëm Lazrin si poet që na bën për vete, por edhe si veprimtar shumë aktiv shoqëroro-politik me qëndrim kritik në sensin pozitiv. Me këtë rast Ai, bëri vlerësim shumë pozitiv për Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini", veprimtarive të saj të dendura të pakrahueshme me shoqatat e tjera duke nxjerrë në pah si askush tjetër vlerat e komunitetit nga vijnë e më gjerë, duke i bërë një shërbim edhe kulturës e historisë nacionale me intelektualizmin e anëtarëve të saj shumë aktiv. Vlerësime maksimale për veprimtarinë poetike të Kodrës, në përgjithësi e për librin e fundit në veçanti dhanë edhe Mjeshtri i Madh i Punës, dramaturgu Fadil Kraja dhe kritiku Kadri Ujka.

Gjallëri kësaj veprimtarie i dhanë me recitimet e tyre të pjesëve kryesore të librit, aktori Tomi Delija, moderatorja Diana Bungu dhe nxënëset e gjimnazit

Kolë Idromeno, Arlinda e Dritëmira. Në fund autori i librit "Mjegull", Lazer Kodra falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, për opinionet që u dhanë, për vlerësimet pozitive që i bënë krijimtarisë së tij, të cilat i shtojnë forcat dhe obligimin për një krijimtarë më cilësorë në të ardhmen. Ai falënderoi edhe mundësorin e botimit të këtij libri, shqiptaro (dukagjinasin)-amerikanin Ndue Ftoni dhe atë që mundësoi veprimtarinë, vëllain e tij Gjergjin. Zoti Lazer bëri edhe një ekspozitë të gjendjes politiko-shoqërore me të mirat e të këqijat e saj, roli i çdo njeriu për ndryshimin e saj sidomos i njerëzve të letrave duke dhënë mesazhe dhe shfaq edhe nuanca optimiste.

Në kuadrin e 10 vjetorit të krijimit të Shoqatës, Kryesia e saj, ka nderuar me titullin "Mirënjohja" Bibliotekën e qytetit tone "Marin Barleti", me motivacion: "Për kontribut të shquar në vlerësimin dhe përçimin e vlerave intelektuale të qytetit tone. Për mbështetjen e pakursyer të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini".

Gjithashtu ka nderuar me titullin "Anëtar Nderi", pedagogun e Universitetit "Luigj Gurakuqi", Gjergj Perluca, me motivacionin: "Intelektual vizionar. Mbështetës i përhershëm në realizimin e misionit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini". Këto tituj, në emër të kryesisë u dorëzuan nga Ndue Sanaj

Familja Kodra në shekuj është shquar për, bukëdhënë, nderbëmës, bujari, humanizëm, duke bere emër në Dukagjin e më gjerë, dukë qenë në kufirin e dy fiseve të mëdha, Shalës e Shoshit. Edhe pse janë larguar nga vendlindja për një jetë ma të mirë, këto veti e virtyte i kanë marrë më vete kudo që kanë shkuar. Prandaj, si edhe herët e tjera, edhe kësaj here ketë veprimtari e mbyllën me një koktejl shumë cilësor ku pjesëmarrësve nuk ju mbeti gjë tjetër vetëm të konsumojnë e te ju thonë: ju rritë ndera e vetëm për evenimente të gëzueshme e shtrofsi.

Të gjithë njëzëri ju urojmë personazhit kryesor të kësaj veprimtarie, Lazer Kodra, jetë të gjatë e shëndet të plotë si dhe një krijimtarë cilësorë e sasiore në të ardhmen si zë i fuqishëm i letrave jo vetëm i Dukagjinit por i gjithë vendit.

Dukate Bregu,
Prelë Shytani

REDAKSIA
Kryeredaktor: Lazer Kodra
Redaktorë: Lazer Stani, Roza Pjetri,
Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja,
Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja